

FATOS DIBRA

PËRTEJ *ALJAMIADOS*: TEKSTET SHQIPE LETRARE TË TRADITËS ISLAME ME ALFABET GREK

(Vijon nga numri paraardhës)

5. Dorëshkrimet bektashiane shqiptare me grafi greke

Në vijim të diskutimit mbi letërsinë bektashiane në gjuhën shqipe po paraqesim disa përfundime me punën që kemi bërë deri tash me një grup dorëshkrimesh bektashiane të shkruara me grafi greke dhe një dorëshkrim me grafi greke dhe arabe. Qasja jonë është më së pari filologjike – në kuptimin më të gjerë të këtij termi.

Dorëshkrimet në fjalë janë përmbledhje tekstesh në disa gjuhë: në shqipe, turqishte, greqishte dhe arabishte. Kjo veçori e dorëshkrimeve kërkon përgatitje shumëdisiplinore, që autori i këtij artikulli nuk pretendon se e ka. Ne kemi arritur të shqyrtojmë kryesisht pjesët në gjuhën shqipe dhe turke. Po ashtu i kemi kushtuar vëmendje edhe pjesëve greqishte dhe arabishte.

Si tekste të traditës islame me grafi greke këto dorëshkrime përbëjnë një dalje nga rregulli i pranuar si i përgjithshëm për traditën shkrimore, sidomos në kontekstin osman, sipas të cilit faktori kryesor që përcaktonte zgjedhjen e grafisë së shkrimit ka qenë gjithnjë përkatësia fetare.¹

5.1. Studimet e deritanishme me dorëshkrimet

Studimi i parë me një dorëshkrim të tillë është bërë nga Zamputi², por siç e kemi përmendur më sipër, kontributi i Zamputit është mjaft i përciptë dhe nuk prek asnjë prej çështjeve që ne i konsiderojmë si thelbësore, më e rëndësishmja e të cilave është vënia në dukje e një thyerjeje të traditës shkrimore të kontekstit islam shqiptar, duke përdorur germet greke për shkrimin e teksteve fetare. Ky aspekt i dorëshkrimit të Zamputit, bashkë me çështje të tjera, është trajtuar nga ana jonë. Kemi pasur rastin të merremi si me pjesët në gjuhën shqipe të këtij dorëshkrimi³, po ashtu edhe me tekstet në gjuhën turke të këtij

¹ Me sa dimë, i pari që e ka artikuluar këtë ‘rregull’ është B. Lewis, *The Emergence of Modern Turkey*, Bot. i 2-të, Oxford University Press, London - Oxford - New York, 1968, f. 425-426.

² Zamputi, “Një dorëshkrim bektashjan...”, 1955.

³ Dibra, *Defteri i Merkos...*, 2013; Dibra, “Marrëdhënia fe-gjuhë-grafi...”, 2018.

dhe të dorëshkrimeve të tjera, që kemi pasur fatin e mirë t'i kemi në dispozicion.⁴ Në punën tonë duhet të përmendim dy avantazhe kryesore: Së pari, është zhvillimi që kanë arritur studimet turkologjike mbi tekstet turqishte të periudhës osmane të shkruara me grafi të ndryshme nga ajo arabe. Këto studime kanë qenë udhërrëfytes shumë i vyer, sidomos për të kuptuar rëndësinë e teksteve të tilla si ato të dorëshkrimeve tona. Së dyti, ka qenë mundësia për të pasur në dispozicion disa dorëshkrime bektashiane me grafi greke, në saje të së cilës kemi mundur të kuptojmë se nuk kemi të bëjmë me një rast të vetëm, por me një dukuri, sado që nuk jemi në gjendje të themi shumë për përhapjen e saj në kohë dhe hapësirë (shih më sipër).

Përpunimi i plotë i gjithë materialit që përmbajnë dorëshkrimet, si dhe zbulimi apo sjellja në vëmendjen e studiuesve të interesuar e dorëshkrimeve të reja të këtij lloji do të hedhë edhe më shumë dritë mbi dukurinë që përfaqësojnë këto tekste.

5.2. Të dhëna të përgjithshme mbi dorëshkrimet dhe autorët e tyre⁵

Dorëshkrimet që paraqesim këtu përmbajnë tekste në gjuhën shqipe, turke, greke dhe arabe. Përgjithësisht mund të themi se kemi të bëjmë me përmbledhje shumëgjuhëshe, por që përbëhen nga tekste të veçanta kryesisht njëgjuhëshe.⁶

Kemi në pasur mundësi të shqyrtojmë gjashtë dorëshkrime. Pesë syresh ruhen në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave - Arkivin Qendror Shtetëror në Tiranë (AQSH).⁷ Një dorëshkrim është në zotërim privat të familjes Muharremaj nga Tepelena.⁸ Ne i kemi emërtuar sipas një renditjeje *ad hoc*, që lidhet me njohjen e këtyre materialeve prej shkruarit të artikullit: D1 deri D6

⁴ Dibra, "Arnavutluk'ta Konuşulmuş...", 2016; Dibra, *19. Yüzyılda...*, 2021; Dibra, "Geleneğin Kıyısında...", 2021.

⁵ Një përshkrim i përgjithshëm i katër prej dorëshkrimeve që paraqesim këtu është bërë edhe tek F. Dibra, *19. Yüzyılda...*, 2021, f. 26-37. Për *Defterin e Merkos* shih edhe Dibra, *Defteri i Merkos...*, 2013; F. Dibra, "Marrëdhënia fe-gjuhë-grafi...", 2018.

⁶ F. Dibra, *19. Yüzyılda...*, 2021, f. 25-37, 98-106.

⁷ Një ndihmë të paçmuar për këto materiale më kanë dhënë Ermal Nurja dhe Sokol Çunga, të cilëve u jam përzemërsisht mirënjohës dhe falënderues.

⁸ Falënderoj me shumë respekt z. Vezir Muharremaj i cili më ka vënë në dispozicion dorëshkrimin që kishte në zotërim familja e tij.

	(shih	më	poshtë	§
Dorëshkrimi	Grafia	Gjuha	Të dhëna (të mundshme) mbi autorin dhe datën	
D1	arabe, greke	sh, tr, gr, ar.	Merko, më gjasë nga rrethinat e Gjirokastrës.	
D2	greke	sh, tr, gr, ar.	1. Hajredin Roshniku, nga Roshniku i Beratit; 2. Mestan Shukarasi, me gjasë nga zona e Beratit.	
D3	greke, {latine}, {arabe}	sh, tr, gr, ar.	1. Sulejman Dukaj, nga Dukaj, Tepelenë; 2. Shahin Dukaj, nga Dukaj, Tepelenë.	
D4	greke	sh, tr, gr, ar.	Fetah efendiu, nga Gjirokastra.	

Tabela 1). Dorëshkrimi i parë D1 në këtë renditje përfaqëson pra dorëshkrimin e parë më të cilin jemi marrë. Por kjo nuk përkon detyrimisht me cilësi ose të dhëna të dorëshkrimeve apo të autorëve / shkruesve të tyre, siç mund të jenë koha fillimit apo e përfundimit të shkrimit të një dorëshkrimi, vendi i shkrimit, moshja e shkruesit etj. Arsyeja kryesore është se këto të dhëna mungojnë thuajse plotësisht.

Dorëshkrimet mund të konsiderohen si ‘manualë për dijen bektashiane dhe ceremonialin specifik të tarikatit’. Ne jemi të mendimit që dorëshkrimet duhet t’i kenë pasur në zotërim persona që kanë qenë më së paku *myhibë* d.m.th. anëtarë të rregullt të tarikatit bektashian, që janë pranuar sipas ritualit përkatës dhe të cilët kanë pasur të drejtë të marrin pjesë në ceremonitë që mund t’i ndiqnin vetëm të iniciuarit.⁹ Nuk përjashtohet mundësia që ndonjë prej autorëve/shkruesve të dorëshkrimeve të ketë qenë dervish.¹⁰

Përveç të dhënave që lidhen me tarikatit, që po i quajmë këtu të përgjithshme, dorëshkrimet përmbajnë edhe të dhëna të tjera, që lidhen me

⁹ Për procesin dhe ritualin e përzgjedhjes së ndjekësve shpirtërorë shih p.sh. Baba Rexhebi, *Misticizma Islame...*, 1970, f. 110 vv.

¹⁰ Dervishët e tarikatit bektashian që i përkasin traditës së *babaganëve* (d.m.th. të grupit që trashëgiminë e përshpirtshme dhe atë të postit fetar e lidh me lidhjen shpirtërore dhe jo me lidhjen e gjakut dhe familjare), të cilët janë po ashtu ndjekës të linjës së Durballit me teqe kryesore Teqenë e Durballit në Farsala, sot në Greqi), përgjithësisht kanë bërë dhe bëjnë betimin e beqarnisë së përjetshme duke hequr dorë nga martesja dhe krijimi i familjes nëpërmjet riprodhimit biologjik. Kundrejt traditës së babaganëve (ose baballarëve) është ajo e *çelebinjve* që përfaqësohet nga ndjekësit e përfaqësuesve të linjës familjare të Haxhi Bektashit që janë edhe kujdestarët e vakëfit të teqesë qendrore (d.m.th. të Teqesë së Haxhi Bektashit në Suluca Karahöyük të Kırşehir-it, në Turqi). Për çështje si marrëdhëniet sociale, administrimi ekonomik, etj. në teqetë bektashiane shih p.sh. Faroqi, *Anadolu'da Bektaşilik*, 2003, passim.

jetën private të shkruesve, p.sh. datëlindjet dhe emrat e fëmijëve, data kur mund të jenë pranuar si anëtarë të rregullt në tarikat, data udhëtimesh të ndryshme etj. Por ka edhe ndonjë të dhënë tjetër, siç është p.sh. është një shënim për hipjen në fron të Sulltan Muratit V, që është shkruar në D4.¹¹

Këto dorëshkrime me grafi greke janë një lloj zgjatimi i dorëshkrimeve të ngjashme me grafi arabe që në aspektin grafik përfaqësojnë normën. Kështu që nuk është gabim të thuhet se në shumicën e rasteve janë tejkshkrime me grafi greke të teksteve që më së shumti janë shkruar me grafi arabe. Por besojmë se ka edhe raste të teksteve që janë shkruar së pari me grafi greke.¹² Nuk jemi në gjendje të themi nëse tekste të tilla mund të jenë riprodhuar më vonë me grafi arabe, prej shkruesish të tjerë. Në këtë artikull nuk do të ndalemi më shumë në çështjen e grafisë.

5.2.1 Gjuhët

Dorëshkrimet, siç u përmend më sipër, përbëhen nga tekste në gjuhën shqipe, turke, greke dhe arabe. Përmbajtja e teksteve në secilën gjuhë plotëson tekstet e tjera, pasi përgjithësisht tekstet nuk janë përkthime të teksteve të tjera në të njëjtin dorëshkrim. Bën përjashtim vetëm një pjesë e teksteve në gjuhën arabe, përkatësisht disa ajete të Kuranit dhe hadithe të profetit Muhamed të cilat në disa raste shoqërohen edhe me një përkthim në gjuhën greke.

Nisur nga vëllimi, shumica e teksteve janë në gjuhën turke dhe greke, pas tyre vijnë tekstet në gjuhën shqipe, kurse tekstet në gjuhën arabe përgjithësisht zënë më pak vend se tekstet e tjera. Megjithatë përqindjet e përdorimit të gjuhëve ndryshojnë nga njëri dorëshkrim në tjetrin.

5.2.2 Përmbajtja

Të gjitha tekstet kanë përmbajtje fetare – përveç pjesëve shumë të pakta, ku jepet ndonjë e dhënë personale apo ku tregohen ngjarje të ndryshme të kohës që nuk kanë lidhje specifike me çështjet e udhës bektashiane. Formalisht mund ndahen në tekste në poezi dhe në prozë. Kjo veçori lidhet edhe gjuhën në të cilën janë shkruar. Mbetet disi problematik klasifikimi nga ky aspekt i teksteve të lutjeve – ku mund të përfshihen edhe ajetet kuranore, – duke qenë se tekstet e ajeteve dhe të lutjeve mund të cilësohen edhe si një lloj teksti i veçantë (sidoqoftë më shumë poezi se prozë).¹³ Po ashtu, është problematike edhe ndarja e ‘poezisë së përshpirtshme’ nga ‘lutja’. Sidoqoftë, të paktën formalisht, lutja me strukturën

¹¹ Në tekst: <1876 μαηου 18 γημερα | τηρητη ~εβη κε ο σουλταν | μουρατης στο ταχη> “[Më] 18 Maj 1876 ditën e martë hipi në fron Sulltan Murati”. Dhënia në këtë formë e kësaj paraqet edhe një rast mjaft interesant të përzierjes së vitit kalendarik diellor (gregorian) dhe vitit fiskal osman (rumī) Dibra, *19. Yüzyılda...*, 2021, f. 37.

¹² Një shembull të tillë na duket se përfaqësojnë disa tekste tek D5.

¹³ Rreth çështjes së ajeteve kuranore shih p.sh. A. Jones, “The paradox of Quranic assonance”, në: *The Balance of Truth. Essays in Honour of Professor Geoffrey Lewis*, Ed. Ç. Balim-Harding & C. Imber, The Isis Press, Istanbul, 2000, f. 179-192.

dhe tiparet e veta prozodike mund të klasifikohet edhe si poezi.¹⁴ Tekstet shqipe përbëhen nga poezi të përshpirtshme: nefese bektashiane dhe gazele; edhe pak tekste në prozë. Tekstet turqishte janë në poezi dhe në prozë: përbëhen nga poezi të përshpirtshme, lutje, rrëfime hagiografike, si dhe nga ndonjë këshillë, formulim të kredos së tarikatit apo urdhëresë për bërjen e veprave të mira dhe largimin nga veprat e këqija. Tekstet greqishte janë përgjithësisht në prozë: përmbajnë rrëfime hagiografike dhe tekste mbi dijen dhe urtësinë e tarikatit bektashian. Tekstet arabishte përbëhen nga ajete kuranore, hadithe dhe lutje, ku tekstet e haditheve konsiderohen (më shumë) si prozë.

Duke qenë se këtu i kemi kushtuar vëmendje teksteve në gjuhën shqipe, do të japin vetëm disa të dhëna që lidhen me këto tekste. Siç u përmend, tekstet shqipe përbëhen nga poezi (ka këtu edhe ndonjë tekst që nuk jemi të sigurt nëse mundet ose jo të klasifikohet si prozë, në D5).

Dorëshkrimet tona nuk përmbajnë poezi të poetëve të mirënjohur, që mund t'i klasifikojmë si klasikët e letërsisë shqipe të traditës islame (si p.sh. Nezimi, Sulejman Naibi, Hasan Zyko Kamberi). Këtu dalin në pah poetë të tjerë, si p.sh. Dalip (e Shahin) Frashëri, Muharrem 'Mahzuni' Babai, Hoxhë Dobi, Sadetin Shapova (ose Shapua), Merkoja. Një pjesë e këtyre autorëve janë prezantuar në shkrime dhe studime të ndryshme dhe mund të konsiderohen autorë shumë të njohur (Dalip Frashëri, Shahin Frashëri, Baba Muharrem Mahzuni) ose të njohur (Hoxhë Dobi) të shek. XIX.¹⁵ Në ndonjë rast kemi poetë që për herë të parë i kemi hasur në këto dorëshkrime, siç është p.sh. Merkoja dhe Sadedin Shapua~Shapova.¹⁶ Një pjesë e këtyre autorëve njihen vetëm në mënyrë fragmentare.¹⁷ Mbi brendinë e teksteve jepen të dhëna më poshtë (shih § 0).

¹⁴ Kemi arritur t'i kushtojmë vëmendje vetëm në mënyrë të përciptë këtij aspekti, khs. Dibra, *19. Yzylda...*, 2021, f. 402-405. Si shkrim ku trajtohet natyra e poezisë dhe çështje që lidhen me të do të sugjeronim E. Hatibi, "Vetmi me njerëz", *Medius*, Nr. 17, 2022.

¹⁵ Ndër burimet kryesore konsiderojmë Myderrizi, "Letërsia shqipe...", 1955; Myderrizi, "Letërsia fetare...", 1955; Osman. "Një dorëshkrim shqip...", 1957; Osman. "Dorëshkrime të vjetra...", 1957; M. Domi, "Letërsia shqipe me alfabet arab", në: *Historia e letërsisë shqipe...*, 1959, f. 249-301; Çollaku, "Rryma letrare...", 1983; Salihu, *Poezia e bejtëxhinjve*, 1987; si edhe veprën e Baba Rexhebit, *Misticizma Islame...*, 1970 [si dhe bot. e 2-të 1995], *passim*, shih edhe Clayer, *L'Albanie, pays...*, 1990, *passim*; Elsie, "Albanian literature...", 1992; Elsie, "Islam and the Dervish...", 1994; Elsie, *The Albanian Bektashi...*, 2019, f. 273-319.

¹⁶ Ky konstatim lidhet me njohurinë e autorit të artikullit dhe nuk do të thotë që nuk gjenden në dorëshkrime të tjera.

¹⁷ Elsie autorët e kësaj kategorie ka preferuar t'i quajë 'autorë minorë': Elsie, "Albanian literature...", 1992, f. 302-304. Sidoqoftë nuk do të ishte e tepërt të thuhej se cilësia kryesore që i bashkon në këtë kategorizim gjithë këta autorë është mosnjohja e tyre sot, më së shumti prej humbjes së veprës.

Tekstet që gjenden në dorëshkrime në mjaft raste janë të njëjta. Autori që haset më shumë është Baba Muharrem Mahzuni, i cili ka qenë një poet prodhimtar. Po ashtu, disa dorëshkrime përmbajnë edhe pjesë nga *Hadikaja* e Dalip Frashërit. Në anën tjetër, ka tekste që hasen vetëm tek një dorëshkrim dhe nuk jemi në gjendje të themi, me të dhënat që kemi në dispozicion, nëse kanë qenë të njohura gjerësisht nga gjithë bektashinjtë, apo bëhet fjalë për tekste me përhapje të kufizuar.

5.2.3 Autorët e dorëshkrimeve

Nuk ka shumë të dhëna për autorët apo shkruesit e dorëshkrimeve, të cilët kanë qenë përgjithësisht 'kopjues'. Por nuk mungojnë rastet kur kanë marrë edhe attribute autoriale, siç është rasti i Merkos (D1) i cili shënon së është autori i *Nefesit të Demir Hanit*.¹⁸ Si autor konsiderojmë edhe Veli Leshnjën (D5) i cili sipas titullit që ka teksti përkatës, del që ka shkruar një prej teksteve më të veçanta në gjuhën shqipe.

Mbështetur në kaligrafinë e teksteve, mund të thuhet se disa dorëshkrime duhet të ketë pasur me shumë se një shkrues. Ne kemi arritur të identifikojmë këta shkrues (të mundshëm) të dorëshkrimeve: Merko (D1); Hajredin Roshniku dhe Mestan Shukarasi (!) (D2); Sulejman Dukaj (dhe Shahin Dukaj) (D3); Fetah efendi (D4); Veli Leshnja dhe Kaso Panariti (D5). Në dorëshkrimin e fundit (D6) nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë të dhënë për shkruesin, por zotëruesi i fundit i tij duhet të ketë qenë Baba Hadër Muharremaj nga Kalivaçi i Tepelenës.

Shkruesit janë që të gjithë nga Jugu i Shqipërisë. Për disa mendojmë se si përcaktues i vendit të origjinës mund të merret mbiemri apo llagapi që kanë përdorur, p.sh. Veli Leshnja, Kaso Panariti, Sulejman dhe Shahin Dukaj duket të kenë qenë përkatësisht nga Leshnja, Panariti dhe Dukaj. Fshati Dukaj besojmë se është lehtësisht i lokalizueshëm si pjesë zonës së Tepelenës. Edhe pse për Leshnjën dhe Panaritin kemi më shumë se një mundësi lokalizimi, na rastin tanë duhet të jetë fjala për lokalitetet që gjenden në rajonin e Skraparit.¹⁹ Një argument është në fakt edhe poezia nga D5, ku autori i tekstit i është referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë Skraparit (shih në § 0 shembullin përkatës në fund të artikullit). Megjithatë në hartën e përgatitur kemi dhënë emrin e vendit, që haset në dy rajone, pa përcaktuar në mënyrë të prerë për cilin Panarit a cilën Leshnjë bëhet fjalë. Edhe pse fillimisht prania e një teqeje bektashiane në një vend të dhënë apo në afërsi të një vendbanimi mund të merret si argument që fshatrat e përmendur (në rastin tonë Leshnjë dhe Panarit) duhet të kenë qenë patjetër në

¹⁸ Shih për këtë çështje Dibra, *Defteri i Merkos...*, 2013, f. 16, 46, 56.

¹⁹ Disa të dhëna mbi kulturën fetare të Leshnjës së Skraparit, që lidhen me traditën bektashiane, gjenden në materialin mjaft interesant të mbledhur nga Ylli dhe Sobolev, p.sh. Xh. Ylli, & A. N. Sobolev, *Albanskij toskskij govor sela Lešnja (kraina Skrapar)*, Bibliion Verlag, Marburg an der Lahn, 2002, *passim*.

zonën ku ndodhej një teqe, një rast tjetër si ai i Hajredin Roshnikut, e bën të diskutueshme këtë mundësi, sepse Roshniku, me sa duket, nuk ka qenë një zonë e lidhur ekskluzivisht me bektashizmin.²⁰ Mënyra si Hajredini Roshniku, i cili shënon se është prej zonës së Beratit – sipas nesh prej Roshnikut – është lidhur me tarikatin mbetet hëpërhë e panjohur. Nëse përmbajtja e një sekuence të dorëshkrimit nuk është kuptuar gabim nga ana jonë, Hajredin Roshniku një kohë duhet të jetë gjendur edhe në Kalivaç. Rasti i tij besojmë se tregon që lidhja e personave të ndryshëm me tarikatin bektashian nuk mbështetet vetëm në traditën familjare dhe se kishte edhe myhibë dhe dervishë që vinin nga rrethe shoqërore që nuk ishin pjesë e “rjetit tradicional” bektashian. Kjo skemë e aderimit është e vlefshme edhe për tarikatet e tjera.

As për Merkon nuk mund të themi me siguri prej cilit vend ishte, por besojmë se vinte nga nja lokalitet pranë Gjirokastrës. Vetëm për Fetah efendiun shënohet se është prej qytetit të Gjirokastrës.²¹

Një tjetër e përbashkët e gjithë këtyre personave, përveç që kanë shkruar me germa greke, është edhe që kanë qenë të lidhur me traditën e Durballi Sulltanit duke mbajtur si teqe qendrore të zonës Teqenë e Durballiut në Farsala të Greqisë.²² Por ka edhe poezi shqipe ku nderohet Sejid Ali Sulltani i njohur

²⁰ Kjo çështje ka nevojë për shqyrtime të mëtejshme, që mund të hedhin poshtë atë që mëtojmë këtu, sidomos në lidhje me ‘skemën e aderimit’ të Hajredin Roshnikut në tarikatin bektashian.

²¹ Për këtë na vjen në ndihmë shënimi që i ka bashkangjitur dorëshkrimit Andrea Sahatçiu si punonjës i Arkivit. Emrin e plotë ‘Andrea Sahatçiu’ e kemi shtuar ne, kurse shënimi në dosje ka vetëm siglën A.S. dhe mban datën 23.04.1979: “Shkrime të një begtashiu me germa greke. Shkrim analfabeti që nuk lexohet. Tre fletët e para janë greqisht. Në fletën e parë shënohet se kur u bë muhib Fetah efendi. Shënohet një lindje fëmije në familje. Në fletën që ka datën 1881 shënohen udhëtime të bëra nga Gjirokastra në Stamboll, në Halep, në Tripoli dhe kthimi në Gjirokastrë pas 11 vjetëve. Në faqen e 2^o që kanë kryedatën 1876 shënohen lindje dhe data të ndryshme të personave të familjes. Faqet e tjera janë lutje dhe vjersha fetare në gjuhën arabe me germa greke.” Mendimi i A. Sahatçiu si specialist duhet mbajtur gjithnjë parasysh, por në këtë rast ne nuk mendojmë se është krejt i saktë përshkrimi në formën <Shkrim analfabeti që nuk lexohet.>.

²² Në kohën kur mendojmë se janë shkruar dorëshkrimet, apo së paku një pjesë e teksteve, *postnishin* (drejtues) i Teqesë së Durballiut ka qenë Baba Muharrem ‘Mahzuni’ (vd. 1869-70 [H. 1286]), shih Kiel i cili për nxjerrjen e kësaj të dhëne është mbështetur në mbishkrimet e mbetura të varreve të baballarëve të Teqesë së Durballiut M. Kiel, “The Bektashi Tekke of Durbali Sultan in Central-Greece: Some Notes on its Architecture, Epigraphy and History”, në: *Sufism and Sufis in Ottoman Society: Sources - Doctrine - Rituals - Turuq - Architecture - Literature Iconography - Modernism*, Ed. A. Y. Ocak, Atatürk Kültür, Dil ve Tarih Yüksek Kurumu, Ankara, 2005, f. 421-441: f. 428; shih edhe Baba Rexhebi, *Misticizma islame...*, 1995, f. 227.

ndryshe si Këzëlldeli, emrin e të cilit mban teqeja e Dimetokës, po në Greqi.²³ Një poezi e tillë gjendet në D1.

Mbetet e panjohur, ose së paku e papërcaktueshme me saktësi koha kur ka filluar dhe kur është përfunduar shkrimi i dorëshkrimeve. Në disa vende gjenden data të ngjarjeve që duhet të kenë pasur rëndësi të veçantë për shkruerit, por këto nuk kanë lidhje me kohën kur është bërë shënimi në tekstet tona. Si kufi të fundit kohor mbajmë dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XIX. Por një pjesë e teksteve, edhe në formën që paraqiten në dorëshkrimet tona, pra me grafi greke, duhet të jenë shkruar më herët.

Veçoritë e përgjithshme të dorëshkrimeve po i paraqesim në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:


Dorëshkrimi	Grafia	Gjuha	Të dhëna (të mundshme) mbi autorin dhe datën
D1	arabe, greke	sh, tr, gr, ar.	Merko, më gjasë nga rrethinat e Gjirokastrës.
D2	greke	sh, tr, gr, ar.	1. Hajredin Roshniku, nga Roshniku i Beratit; 2. Mestan Shukarasi, me gjasë nga zona e Beratit.
D3	greke, {latine}, {arabe}	sh, tr, gr, ar.	1. Sulejman Dukaj, nga Dukaj, Tepelenë; 2. Shahin Dukaj, nga Dukaj, Tepelenë.
D4	greke	sh, tr, gr, ar.	Fetah efendiu, nga Gjirokastra.

Tabela 1: Skemë e veçorive të dorëshkrimeve

Një shpërndarje të dorëshkrimeve sipas origjinës – ndonjëherë të hamendësuar – të shkruerave është paraqitur në figurën/hartën më poshtë.²⁴ Kjo shpërndarje mund të mos ketë aspak lidhje me vendin ku janë hartuar përmbledhjet:

²³ Teqeja e Sejid Ali Sulltanit mbahet si teqeja më e rëndësishme bektashiane në Ballkan dhe vinte pas teqesë qendrore në Haxhibektash të Turqisë.

²⁴ Një figurë/hartë të ngjashme e kemi paraqitur më parë tek F. Dibra, “Geleneğin Kıyısında...”, 2021, f. 247.



6. Disa tipare të teksteve të dorëshkrimeve

Gjithnjë mbajmë në vëmendje që poezia luan një rol të veçantë në përcjelljen dhe formësimin e traditës bektashiane. Edhe veprat themelore në prozë kur vjen puna tek komunikimi dhe përcjellja e dijes, ndërthuren me poezinë dhe njëfarësoj vendoset në shërbim të asaj që përcjell poezia, edhe pse në hierarkinë e informacionit teksti në prozë mund të jetë më i rëndësishëm dhe më parësor se ai i poezisë. Në letërsinë në gjuhën shqipe poezia duket se merr edhe më shumë rëndësi. Sidomos dy tekste të përkthyer (mbase mund të jetë më saktë të themi përshtatura) nga turqishtja në shqipe, siç janë *Hadika*-ja e Fuzulit e sjellë në gjuhën shqipe prej Dalip Frashërit dhe *Muhtarname*-ja²⁵ e

²⁵ Për burimin e *Muhtarnames* me sa dimë nuk ka një të dhënë të prerë. Edhe të dhënat që jepen në artikuj të ndryshëm nuk është krejt e qartë nga janë vjelë, por mundet që si burim kryesor ka shërbyer materiali që ka përgatitur Myderrizi – edhe ende i pabotuar. Me sa kemi arritur të shohim, Domi është i pari që shkruan se vepra në origjinal është në persishte, por që Shahin Frashëri është mbështetur në përkthimin e saj turqisht Domi, “Letërsia shqipe...”, 1959, f. 301. Këtë të dhënë e ka marrë edhe Mufaku (M. Movako, “Arnavutluk’ta Bektaşî Edebiyatı”, në: *Hacı Bektaş Veli Araştırma Dergisi*, Vol. 6, Nr. 10, 1999 [origjinali arabisht 1980], f.51-60: f. 56); Mufaku, *Lidhjet letrare...*, 2009, f. 144-145; prej Mufakut duket se e ka marrë edhe Norris (Norris, *Islam in the Balkans...*, 1993, f. 181). Elsie thotë se “[...] vepra mbështetet në origjinalin persisht, por është ndikuar prej një përkthimi turqisht.” (Elsie, “Albanian

kthyer prej Shahin Frashërit, janë dy vepra në vargje që mbështeten në dy vepra, e para në prozë dhe në vargje dhe e dyta në prozë.²⁶

Në tekstet e dorëshkrimeve lëvrohen disa “zhanre” (që ndonjëherë mund të ngërthehen edhe në një tekst të vetëm). Në formë liste mund t’i paraqesim përmbledhtas si më poshtë:

- himne fetare;
- tekste hagjiografike (me elemente të mitologjisë islame);
- tekste elegjiake;
- tekste ‘historike’;
- tekste ‘propagandistike’;
- tekste ‘polemike’;
- [tekste epike].

Tekstet e dorëshkrimeve dëshmojnë një marrëdhënie mes teksteve dhe autorëve, si dhe mes hierarkive të figurave të ndryshme që në tekste paraqiten si figurë qendrore. Marrëdhënia mes teksteve dhe autorëve shihet sidomos në tekstet që janë përkthime ose përshtatje nga gjuha turke në gjuhën shqipe; si dhe në tekste që janë përshtatje të teksteve më të hershme në gjuhën shqipe. Teksti më i rëndësishëm brenda korpusit të teksteve bektashiane mbetet *Hadikaja* e Dalip Frashërit. Kjo vepër, siç është vënë në dukje qysh prej fillimit të shekullit të kaluar nga Mithat Frashëri dhe më pas edhe nga Myderrizi²⁷, është shkruar duke përkthyer dhe përshtatur veprën turqishte me të njëjtin emër të Fuzuliu. Por janë të rëndësishme për studimin e traditës letrare bektashiane edhe poezi të tjera që i kemi përmendur me sipër (shih § **Error! Reference source not found.**).

Një shembull interesant përbëjnë përshtatjet e veprave dhe teksteve të mëhershme në gjuhën shqipe, të cilat janë përpunuar nga autorët bektashianë

literature...”, 1992, f. 301). Si vit i përfundimit të përkthimit të Sh. Frashërit jepet viti 1868. Më anë tjetër, përkthimi i *Muhtarname-s* në gjuhën turke, është i hershëm. Njihet së paku një variant i Dervish Mahfi-ut, që i përket mesit të shek. XVII, i cili shkruan se punën e ka nisur në muajin shev-val të vitit 1056 [nëntor-dhjetor 1646] (E. Duman, *Derviş Mahfi Muhtâr-Nâme (inceleme-metin): 1a-31b. varaklar arası*, Yüksek Lisans Tezi, Kocaeli Üniversitesi, 2020, f. 1). Vepra me sa duket është kopjuar më se një herë në kohë të ndryshme: Duman ka punuar me një kopje të përfunduar më 14 zilhixh-xhe 1272 [16 gusht 1856]. Ne kemi pasur rastin të shohim edhe një kopje tjetër pa datë, që i përkiste Teqesë së Konicës dhe sot ruhet në AQSH. Edhe ky dorëshkrim i AQSH-së është kopje veprës së Dervish Mahfi-ut, me ndryshim të vogël në tekst prej kopjes së punuar nga Duman. Nuk jemi në gjendje të themi ku është mbështetur Shahin Frashëri, por nuk është e pamundur që edhe ai të jetë mbështetur në një kopje të përkthimit të Dervish Mahfi-ut.

²⁶ Kjo veçori e kthimit në shqipe, në lidhje me *Hadikanë* është vënë në dukje së pari prej Myderrizit: Myderrizi, “Letërsia fetare...”, 1955, f. 135.

²⁷ Myderrizi, “Letërsia fetare...”, 1955, f. 135.

shqiptarë sipas shijes së tyre dhe mendësisë së tarikatit. Siç u përmend edhe më sipër, në zanafillë këto vepra nuk kanë lidhje me tarikatit bektashi (§ **Error! Reference source not found.**). Ndjekja e rrugëtimit të tyre nëpër tekste dhe variante na ndihmon kuptojmë edhe një aspekt të intertekstualitetit të letërsisë shqipe të traditës islame. Teksti që kemi marrë si shembull shërben edhe si një pasqyrë të transferimit të hierarkive, që mund të skematizohet në formën:

Profeti Muhamed → Aliu {→ Sari Salltiku}.

Poezia origjinale i kushtohet profetit Muhamed. Në variantin bektashian që haset në dorëshkrimet me grafi greke si figurë qendrore del Aliu ose edhe Sari Salltiku. Megjithatë, në një dorëshkrim bektashian të viteve '40 të shek. XX, figurë qendrore është përsëri profeti Muhamed. Duke pasur në vëmendje edhe këtë shembull nuk jemi në gjendje të themi se cili variant do të ketë qenë më “normativi” në rrethet bektashiane deri në gjysmën e shek. XX. Një element tjetër i variantit bektashian të poezisë është shkëputja e lidhjes me variantet e mëhershme jobektashiane. Madje në njërin variant si autor i tekstit jepet Abdullah Melçani.²⁸

Një tekst tjetër që është përpunim i një teksti jobektashian është *Nefesi i Demir Hanit*, me autor Merkon. *Demir Hani* i Merkos është një përshtatje në vargje e rrëfenjës së Demir Hanit që ka qarkulluar më parë në prozë.²⁹ Edhe në këtë rast autorësinë e merr Merkoja i cili disa faqe pas tekstit të poezisë ka shkruar: “*edhe nefezë e Demir Hanit fakiri Merko e ngriti 'jëmendi sa të kem ymrë do të më rijë rehat shpirti'*”. Shembulli i përshtatjes që ka bërë Merkoja është edhe tregues i hierarkisë së teksteve, ku gjithnjë vendin e zgjedhur e ka pasur poezia.³⁰

Në tekst kemi shembuj të ngjarjeve që mund të konsiderohen “globale” (ngjarja e Qerbelasë) dhe syresh që mund t'i shohim si ngjarje “lokale” (p.sh. ngjarja e Demir Hanit). Ka edhe shembuj që, ndonëse nuk mund të thuhet se reflektojnë një ngjarje “globale”, prapëseprapë, për vetë shtrirjen dhe ndikimin që mund të ketë pasur ngjarjet nuk mund të konsiderohen as “lokale” (p.sh. *nefesi i Baba Muharremit* për jeniçerët).

Ngjarja e Qerbelasë ka vërtet një vend qendror në letërsinë islame në përgjithësi. Me këtë ngjarje lidhet lindja e një zhanri elegjiak siç është ai

²⁸ Për një krahasim të këtyre varianteve shih Dibra, *Defteri i Merkos...*, 2013, f. 43-45.

²⁹ Për rrëfenjën në prozë të Demir Hanin shih Osman, “Dorëshkrime të vjetra...”, 1957, f. 195-198.

³⁰ Shih edhe Dibra, *Defteri i Merkos...*, 2013, f. 46, 56. Ka shumë mundësi që varianti dhe autorësia e Abdullah Melçanit janë më të njohurat dhe më të përhapurat në dorëshkrime. Përfshirja në këtë mënyrë edhe në librin e Baba Rexhebit besojmë se përbën dëshminë më të rëndësishme.

mersije-s.³¹ Shumë vepra me karakter epik lidhen po ashtu me ngjarjen e Qerbelasë.³² Sipas Myderrizit veprat bektashiane janë të parat në gjuhën shqipe ku është lëvruar zhanri i epikës.³³ Në kontekstin e letërsisë bektashiane shembulli më i përhapur duket se ka qenë pjesë e tekstit e *Hadikasë*, ku fjalë për këtë ngjarje.³⁴ Përkujtimi i ngjarjes së Qerbelasë është njëkohësisht edhe pjesë e ceremonialit të *matemit* (zisë) për vrasjen e Hysejnit dhe shokëve të tij. Shkrimi i këtij teksti në gjuhën shqipe dhe futja në ceremonialin që zhvillohet sipas kalendarit hënor (hixhri) në dhjetë ditët e para të muajit muharrem, përbën edhe një ndërrim në gjuhën e përdorur gjatë këtij ceremoniali ritual bektashian. Konica, që matemin e konsideron “*kreshma e bektashive*”, shkruan: “*Më 1 gjer më 10 të Mait, Matem, do me thënë rrojtje në zi, pa ngrënë mish e pa pirë ujë. Ditë për ditë këndohet Hadikaja, shqip a gërqisht, në Toskëri, e turqisht ndër bektashit e anës Kallkandelenit.*”³⁵

Një ngjarje që e kemi konsideruar si të ndërmjetme (jo tamam “globale”, por as “lokale”) është shkrimi e korpusit të jeniçerëve prej Mahmutit II. Në fakt ngjarja meriton të futet në grupin e parë (pra të konsiderohet “globale”), sepse ka pasur impakt si në zhvillimet e brendshme në Perandorinë Osmane, ashtu

³¹ Për një vështrim në lidhje me letërsinë turke shih I. Mélikoff, “Le drame de Kerbelâ dans la littérature épique turque”, në: *De l'épopée au mythe: Itinéraire turcologique*, Éditions Isis, Istanbul, 1995, f. 41-55; për shembuj kjo letërsi shih p.sh. B. Çağlayan, *Kerbelâ Mersiyeleri*, Doktora Tezi, Gazi Üniversitesi, 1997, *passim*.

³² Një syresh dhe ndoshta ndër më të rëndësishmet është tregimi i bëmave të Ebu Muslimit *teberdarit* të Horasanit, i cili konsiderohet kreshniku që do të marrë hakun e dëshmorëve të Qerbelasë; për variantin në gjuhën turke shih p.sh. I. Mélikoff, *Abū Muslim, le “Porte-Hache” du Khorassan, dans la tradition épique turco-iranienne*. Adrien Maisonneuve, Paris, 1962; I. Mélikoff, “Abu Muslim, patron des akhis”, në: *De l'épopée au mythe...*, 1995, f. 35-40. Kopje në gjuhën turke të tregimit të Ebu Muslimit gjenden edhe në AQSH.

³³ Myderrizi, “Letërsia fetare...”, 1955, f. 131. Këtu mund të vijë menjëherë në mendje eposi i kreshnikëve, si vepra më përfaqësuese e epikës në letërsinë shqipe. Në rastin tonë bëhet fjalë më së pari për vepra që i njohim si tekste të shkruara. Më anë tjetër, vjen si pjesë e traditës bektashiane, apo vijim i saj, vepra e Naimit *Qerbelaja*, me të cilën nuk do të merremi në shqyrtimin tonë këtu. Në rastin e studimit të veprës së Naimit ka një traditë të mirëfilltë në Shqipëri, Kosovë dhe më gjerë. Si një artikull mjaft specifik kushtuar *Qerbelasë* së Naimit po përmendim këtu vetëm G. Duijzings, Ger. “Qerbelaja e Naim Frashërit: Feja dhe politika në Shqipëri”, në: *Përpjekja*, Nr. 15-16, 1999, f. 44-57.

³⁴ Nëpër dorëshkrimet tona gjenden edhe poezi të veçanta në gjuhën turke që i kushtohen ngjarjes së Qerbelasë. Por nuk kemi një hulumtim për krijimtarinë që mund t'i jetë kushtuar kësaj ngjarjeje në gjuhën shqipe. Për momentin mund të themi vetëm që poezi të tilla nuk mungojnë.

³⁵ F. Konitza, *Kalëndari i Malévé - me zburimé per 1900*, Perlindia é Shqipetarevé, Bruxelles, 1900, f. 25-26.

edhe në zhvillimet përtej kufijve të saj. Kjo vërehet edhe nëse nisemi nga perspektiva bektashiane e reflektuar në poezinë e Baba Muharrem Mahzunit, që kemi marrë si shembull këtu.³⁶ Poezia bën fjalë për ‘shkatërrimin e padrejtë’ të jeniçerëve të cilët shihen si mbrojtësit e vendit nga armiqtë (*Moskovi dhe frëngu i detit*). Si personazhi negativ kryesor është Estrefi i cili përshkruhet si ‘soji i Jezidit, Jezid’ e ‘Mervan’ dhe si dinjitar a funksionar i sulltan Mahmutit II. Emri Estref [~ Istref], siç e ka vënë në dukje Dizdari, është variant i emrit Hüsrev ~ Husrev.³⁷ Estrefi i poezisë së Baba Muharremit ka mundësi të jetë Koxha Husrev Pasha [tur. Koca Hüsrev Paşa], i cili ka pasur një rol të rëndësishëm në reformat e Mahmutit II.³⁸ Në poezi është vënë në shënjestër edhe vetë Mahmuti II. Në këtë poezi mund të shihet një paralelizëm me një poezi kretase në gjuhën greke, ku merret sërish tema e eliminimit të jeniçerëve - por këtë radhë bëhet fjalë për personazhe lokale kretase më shumë se për jeniçerët në përgjithësi.³⁹ Poezia e Baba Muharremit mund të konsiderohet edhe një tekst propagandistik, sado që personazhet që përmenden në poezi me emër nuk i përkasin kohës kur besojmë se është shkruar poezia (ndoshta në vitet 1850!).

Në dorëshkrime paraqiten edhe disa ngjarje me karakter “lokal”. Si zhvillimi ashtu edhe ndikimi i tyre duhet të ketë qenë i kufizuar me zonën e Jugut të Shqipërisë. Teksti i parë është *nefesi i Demir Hanit*. Siç u përmend më sipër, rrëfenja e Demir Hanit, që është përshtatur në vargje prej një bektashiu (Merkos), ka qarkulluar më parë në prozë si një tekst pa lidhje të veçantë me tarikatën bektashian. Nisur nga burimi me i hershëm që ka botuar Myderrizi, personazhet pozitive të kenë qenë të lidhur me tarikatën sadi.⁴⁰ Të gjitha tekstet bektashiane në lidhje me Demir Hanin duket së janë më të vona se teksti në prozë.⁴¹ Megjithatë në kohën kur është përpunuar nga Merkoja - teksti i të cilit përbën variantin më të plotë të poezive bektashiane - duhet të ketë qenë reflektim edhe i një konflikti a gjendjeje të tensionuar, ku protagonistë ka gjasë të kenë qenë edhe bektashinjtë. Tjetër tekst, që paraqet një polemikë ku përfshihen bektashinjtë, është edhe një tekst i Veli Leshnjës (D5: 59a-60b). Këtu jepet një dialog i një bektashiu me një hoxhë për disa çështje fetare, ku

³⁶ Për poezinë dhe një koment rreth saj shih F. Dibra, *Defteri i Merkos...*, 2013, f. 36-41.

³⁷ T. Dizdari, *Fjalor i orientalizmave...*, 2005, f. 257.

³⁸ Për të dhëna mbi jetën dhe veprimtarinë e Koxha Husrev Pashës shih p.sh. H. İnalçık, “Hüsrev Paşa, Koca”, në: *TDV İslâm Ansiklopedisi, Vol. 19, Türkiye Diyanet Vakfı, İstanbul, 1999, f. 41-45.*

³⁹ Për këtë poezi shih Dedes, “Blame it on the Turko-Romnioi...”, 2011.

⁴⁰ Shih O. Myderrizi, “Një dorëshkrim shqip...”, 1957, f. 195v.

⁴¹ Për një hulumtim mbi Demir Hanin sugjerojmë: E. Hatibi, “Demir Hani”, në: *E-Zani i Naltë* (revistë në internet), 2020, <https://www.e-zani.org/2020/03/07/demir-hani/> (qasja: 18.10.2022).



bektashiu tregohet më i ditur se hoxha dhe zotërues i dijes së fshehtë. Megjithatë nuk është krejt e qartë nëse kjo narrativë reflekton një ngjarje që mund të ketë ndodhur njëmend në zonën ku supozojmë se ka jetuar Veli Leshnja, apo nëse kemi të bëjmë me një ndikim nga letërsia bektashiane, apo më saktë nga ato që njihen si *anekdota bektashiane*. Në rastin e dytë referenca lokale do të ishte e pavlefshme.


Tekstet hagiografike përfaqësohen me disa poezi, por besojmë së ndër më interesantët është një tekst mbi ardhjen e Këzëlldeliut (i njohur edhe si Sejjid Ali Sulltan) në Rumeli. Sipas traditës bektashiane Këzëlldeliu është trashëgimtar i Haxhi Bektashit dhe babai i Ballëm Sulltanit themeluesit të tarikatis bektashi (R. Yıldırım, *Rumeli'nin Fethinde ve Türkleşmesinde Öncülük Etmış Bir Gâzi Derviş: Seyyid Ali Sultan (Kızıldeli) ve Velayetnâmesi*, Türk Tarih Kurumu, Ankara, 2007, f. 23-36). Këtë tekst, që gjendet në D1, nuk e kemi hasur në ndonjë vend tjetër. Me të plotësohet edhe më mirë tematika e teksteve letrare bektashiane në gjuhën shqipe.

7. Shembujt

Nga dorëshkrime të ndryshme:

7.1. Shembull nga D1:






Kemther̃i ashikërisë
 dalldisi si peshku në-det,
 bejtinë Këzëll Delisë
 pa e dëgjoni se si e flet
 për atë Zot të vërtetë,
 s'ka i-llaf mor ashikanë,
 e nisi me dymbëdhietë
 fukara e-dervishanë,
 kur e nisi zoti hunqar
 e nisi Këzëll Delinë,
 e-i-tha të bëra serdar
 të veç të çjionç Rumelinë,
 mori udhënë aji bret,
 e ju bë shandani murat,
 kur vate dër undë, medet,
 i bëri vaki mushqylat,
 atije u-poq me gjemixhinë
 i kërkoi dollipahanë,
 pyenë Këzëll Delinë,
 hasllëk nukë kishte pranë,
 ata nukë kishnë para,
 i deroji haku hatemi,
 pandaji i bëri fukara,


të gjejnë derman alemi,
 bëri emrë serdar̃ Rum,
 ẽĩtha Dervish Balisë,
 pa e mbush biqnë me kum,
 t'i derdhë mi Rumelisë,
 e mbushi biqnë me kum
 ktheji'e po e hap në det,
 kerameti serdarit rum
 që na e bën udhë në det,
 aji që bante tëmonë
 e pa detnë po heth tallas,
 pa shubhe, ashtu e thonë,
 thanë që është Hëzëri Iljias
 Thiri i par'i qemisë (gjemisë),
 aty tek ini qëndroni,
 për iza të Perëndisë,
 merhamet mbi na punoni,
 bëri emrë serveri rum,
 aji mbreti Rumelisë,
 aherë jia vu Durbali,
 e lëshoji kumnë biqsë,
 thiri gjemisë, e lëshoji,
 të vijë t'u marr e t'u xier,

se ç'ini ju u kupëtova,
 edhe në det po bënë hyner
 sa vanë e grehnë përtejti,
 e hëngërë gani nimenë,
 pa erdhë e shkundë për këteji,
 mbi na hodhe me (!) rahmenë,
 aji që bante sufranë,
 i thoshinë dervishi jakut
 Kur-do që mejton dergjahnë,
 Zavalli (m)bëneji për tabut
 Aji që bante nufirë,

i thoshinë dervishi shyqri,
 kur-do që mejtonte pirë,
 luante nëha fiq[i]ri,
 Dalipi xhefatë si kum,
 që s'kanë numur e-anë,
 pandaji i thërres serdarit rum,
 aji na bëftë dermanë,
 dem-be-dem bën kerem aji zat,
 si e nderoji Rumelinë,
 na dërgoji edhe nevet në fshat,
 sulltan gonxhë Nasibinë. Hu dost

7.2. Shembull nga D5





[51a]

ti moi erdhia | plakë
 të të lëfdonë | çë kë me hak
 moi pjergulla | me kavak
 sa e mira që je | tinë
 moi vlatiga | kur më idhe

me ca lisa | me ca vidhe
 na bën edhe | aguridhe
 që ndërtoimë | edhe jahninë
 [051b]
 ti ke (!) ca hallë | të tiera
 kur të të bënë të | vera | xhyerë

kur të të | edhën në kadar
 e kulluarë | si ar
 të marrëtë | të mos të të pinë
 more rrush e mira | jote
 po s'u bëre | ixhat sot
 jallah | t'laçim për bërsy me mot
 që na bën | edhe rakinë
 kur të edhin | në filxha(n)
 [052a]
 arshikët | i bën e qan
 u rrënkë (!) në | mëngjest
 në filxhan | më rri si dritë
 natënë | ma bën si ditë
 më të pifshin | bektashitë
 ashtu sikundër | të dinë
 bektashitë | e kanë fars
 do ta pinë | me nijas
 se u kë mbe|tur miras
 ata që të | mos të të pinë
 ti je për | peshqesh
 ti e bën | njerinë qesh

[052b]
 lum ay | që të mori vesh
 sa e mira që je tinë
 ti e bën ve|zirë mbret
 ty njeriju | të ka kuvet
 se të ka çularë si shishë
 ay stof (!) pej | perë(n)disë
 morë shkopi | pleqërisë
 sa e mira | që je tinë
 ti je që | në ahiret
 ti more të | gjorën piten (!)
 [053a]
 jallah | i paska ta dinë
 moj raki moj | bukurinë
 piesh me meze | majjoshë
 se për ty desha | të thoshë
 kur ngriem | që në mëngjest
 të mos pi ty kupë vdes
 si shof të të | bër pekmes
 edhe skrapari | rehaninë.

BIBLIOGRAFI

- Dorëshkrim*, AQSH: F. 143, D. 1708, [s.d.].
- Abazi-Egro, Genciana, “Dy dokumente të panjohura mbi jetën e poetit Nezim Berati (shek. XVIII)”, *Studime Historike* 1-2 (2013), f. 265-271.
- Abazi-Egro, Genciana, *Hasan Zyko Kamberi - Poezi*. Re. Genciana Abazi-Egro. Botimet Albanologjike, Tiranë, 2016.
- Abazi-Egro, Genciana, “Literary Patronage of the Albanian Vlora Dynastic Family, 1670-1764”, *Polis* 18 (2019), f. 5-21.
- Abazi-Egro, Genciana, *Nezim Berati - Divani shqip*. Re. Genciana Abazi-Egro. Toena, Tiranë, 2009.
- Abazi-Egro, Genciana, “Nga dorëshkrimet në botimet kritike: mbi procesin e njohjes së letërsisë së bejtexhinjve”, *Studime filologjike*, 3-4 (2010), f. 169-184.
- Abazi-Egro, Genciana, “Sami Frashëri dhe letërsia e bejtexhinjve: një sprovë e parë për botimin e Divanit të Nezim Frakullës”, *Studime filologjike*, 1-2 (2005), f. 119-164.
- Abu-Manneh, Butrus, “Between Heterodox and Sunni Orthodox Islam: The Bektashi Order in the Nineteenth Century and Its Opponents”, *Turkish Historical Review* 8.2 (2017), p. 203-218.

- Ajeti, Idriz, “Pamje historike e ligjerimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX”, *Studime dialektore dhe etimologjike*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005, f. 217-302.
- Algar, Hamid, “The Hurûfî Influence on Bektashism”, *Bektachiyya: Études sur l'ordre mystique des Bektachis et les groupes relevant de Hadji Bektach*. Re. Alexandre Popovic dhe Gilles Veinstein. Éditions Isis, Istanbul, 1995, p. 39-53.
- Aliu, Ali, Sabri Hamiti dhe Mehmet Kraja, *Historia e letërsisë shqipe: Materialet e Konferencës shkencore*, 30-31 tetor 2009, në Prishtinë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2010.
- Ambros, Edith Gülçin, “Coffee's Elegy on the Death of Tobacco, 1636-1637 by Vardarlı Fazlı: An Ottoman Social Parody and its Linguistic Particularities”, *"Buyurdum ki..." - the whole world of Ottomanica and beyond: Studies in honour of Claudia Römer*. Re. Hülya Çelik, Yavuz Köse dhe Gisela Procházka-Eisl. Brill, Leiden – Boston, 2023, p. 106–124.
- Ashta, Kolë, *Leksiku historik i gjuhës shqipe, III*, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, 2000.
- Atalay, Besim, *Bektaşilik ve Edebiyatı*. Matbaa-i Âmire, İstanbul, 1340.
- Aydemir, Yaşar, “Ravzî'nin Rumeli İzlenimleri”, *Turkish Studies* 4.2 (2009): 215-235.
- Ballgjati, Edmir, *Kënga qytetare shkodrane: Nga 'ahengu' tek 'kënga qytetare'*. Tezë Doktorature. Qendra e Studimeve Albanologjike, 2014.
- Ballgjati, Edmir, “Një dokument i panjohur më parë: notizimi më i hershëm në pentagram në lidhje me këngën tradicionale shqiptare”, *Identitet kulturor shqiptar në 100 vjet*. Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2013, f. 131-137.
- Balta, Evangelia and Mehmet Ölmez, *Between Religion and Language*. Eren, Istanbul, 2011.
- Barkan, Ömer Lütfi, “Osmanlı İmparatorluğu'nda Bir İskân ve Kolonizasyon Metodu Olarak Vakıflar ve Temlikler I: İstilâ Devirlerinin Kolonizatör Türk Dervişleri ve Zâviyeler”, *Vakıflar Dergisi* 2 (1942): 279-386.
- Barkan, Ömer Lütfi, “Osmanlı İmparatorluğunda Bir İskân ve Kolonizasyon Metodu Olarak Sürgünler”, *İstanbul Üniversitesi İktisat Fakültesi Mecmuası* 9.1-4 (1949-1950): 524-569.
- Bartl, Peter, *Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung (1878-1912)*. Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1968.
- Bausani, Alessandro, “Le lingue islamiche: interazioni e acculturazioni”, *Il mondo islamico tra interazione e acculturazione*. Re. Alessandro Bausani dhe Biancamaria Scarcia Amoretti. Roma: Università degli Studi di Roma, Istituto di Studi Islamici, 1981, p. 3-19.

- Birge, John Kingsley, *The Bektashi Order of Dervishes*. Luzac & Co, London, 1937.
- Bria, Gianfranco, "The Case of Albanian as an Islamic Language between Muslim Literary Tradition and National Culture", *Eurasian Studies* 18 (2020), p. 57-72.
- Bruinessen, Martin van, "Review: Irène Mélikoff, Hadji Bektach: un mythe et ses avatars. Genèse et évolution du soufisme populaire en Turquie, Leiden, Brill, 1998", *Turcica* 31 (1999), p. 549-553.
- Buharaja, Vexhi, "Një vështrim panoramik mbi të kaluarën e Beratit", Sinani, Shaban. *Berat, Beratinus, Buhara: Një udhëtim historik-kulturor nëpër mijëvjeçarët e qytetit*. Naimi, Tiranë, 2015, f. 245-284.
- Çabej, Eqrem, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*. Re. Brikena Çabej. MÇM, Tiranë, 1994.
- Çabej, Eqrem, *Studime etimologjike në fushë të shqipes K-M*. Re. Brikena Çabej, Anila Omari dhe Seit Mansaku. Vëll. i 5. Çabej, Tiranë, 2014.
- Çağlayan, Bünyamin, *Kerbela Mersiyeleri*. Doktora Tezi: Gazi Üniversitesi, 1997.
- Clayer, Nathalie, *Aux origines du nationalisme albanais: La naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe*. Karthala, Paris, 2007.
- Clayer, Nathalie, *L'Albanie, pays des derviches: Les ordres mystiques musulmans en Albanie à l'époque post-ottomane (1912-1967)*. Otto Harrassowitz, Berlin – Wiesbaden, 1990.
- Clayer, Nathalie, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*. Përkth. Artan Puto. 2. Botime Përpjekja, Tiranë, 2012.
- Clayer, Nathalie, "The Myth of Ali Pasha and the Bektashis: The Construction of an 'Albanian Bektashi National History'", *Albanian Identities: Myth and History*. Re. Stephanie Schwander-Sievers dhe Bernd J. Fischer. Indiana University Press, Bloomington – Indianapolis, 2002, p. 127-133.
- Çollaku, Shaban, "Rryma letrare e bejtexhinjve", *Historia e Letërsisë Shqiptare - që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare*. Re. Dhimitër S. Shuteriqi, etj. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1983, f. 58-75.
- Csirkés, Ferenc, "Turkish /Turkic Books of Poetry, Turkish and Persian Lexicography: The Politics of Language Under Bayezid II." *Treasures of Knowledge: An Inventory of the Ottoman Palace Library (1502/3–1503/4). Volume I: Essays*. Re. Gülru Necipoğlu, Cemal Kafadar dhe Cornell H. Fleischer. Leiden - Boston: Brill, 2019, p. 673-733.
- Dankoff, Robert, *An Evliya Çelebi glossary: unusual, dialectal and foreign words in the Seyahat-name*. Harvard University, The Department of Near East Languages and Civilizations, Cambridge, Massachusetts, 1991.

- Dankoff, Robert, "The Alexander romance in the Dīwān Lughāt at-Turk", *Humaniora Islamica* 1 (1973), p. 233-244.
- Dedes, Yorgos. "Blame it on the Turko-Romnion (Turkish Rums): A Muslim Cretan song on the abolition of the Janissaries." *Between Religion and Language: Turkish-Speaking Christians, Jews and Greek-Speaking Muslims and Catholics in the Ottoman Empire*. Re. Evangelia Balta dhe Mehmet Ölmez. Eren, İstanbul, 2011, p. 321-376.
- Dedes, Yorgos. "Was there a Greek Aljamiado Literature?", *The Balance of Truth: Essays in Honour of Professor Geoffrey Lewis*. Re. Çiğdem Balım-Harding dhe Colin Imber. İstanbul: The Isis Press, 2000, p. 83-98.
- Demiraj, Bardhyl, "Aleksandri i Madh i Maqedonisë në mendimin intelektual-albanologjik shqiptar", *Studime Albanologjike* 10 (2014), f. 9-23.
ose jo e materialeve të shkruara, të cilat shërbejnë për arsimimin gjuhësor dhe alfabetizimin e bashkësisë, që e flet gjuhën; 7. Qëndrimet dhe politikat gjuhësore qeveritare e institucionale, përfshirë statusin zyrtar dhe përdorimin e gjuhës; 8. Qëndrimet e anëtarëve të komunitetit ndaj gjuhës së vet; 9. Sasia dhe cilësia e dokumentimit. Jemi të vetëdijshëm, sidoqoftë, se vlerësimi i vitalitetit gjuhësor është një proces i ndërlikuar e kompleks, që shkon përtej skemave apo modeleve konceptuale të ideuara prej studiuesve.

1. **Transmetimi i gjuhës ndër breza** konsiderohet si indikator i më i rëndësishëm i vitalitetit të një gjuhe, i cili matet, siç e përmendëm më lart, sipas një sistemi, që përcakton shkallën e rrezikimit të një gjuhe: (5) “gjuhë e sigurt” (*safe*), kur një gjuhë flitet nga të gjithë brezat dhe transmetimi i saj bëhet në mënyrë të pandërprerë; (4) gjuhë e **pasigurt** (*unsafe*), kur pjesa më e madhe e familjeve e përdorin atë gjuhë për të komunikuar në shtëpi dhe fëmijët e mësojnë si gjuhën e tyre të parë; (3) gjuhë **vërtetë e rrezikuar** (*definitely endangered*), kur gjuha përdoret më së shumti nga brezi i prindërve, kurse fëmijët nuk e mësojnë si gjuhë të parë në shtëpi; (2) “gjuhë **seriozisht e rrezikuar**” (*severely endangered*), kur ajo flitet vetëm nga brezi i gjyshërve dhe stërgjyshërve, ndërsa brezi i prindërve e kupton, por nuk e përdor për të komunikuar me fëmijët; (1) gjuhë **tërësisht e rrezikuar** (*critically endangered*), kur gjuha flitet vetëm prej shumë pak njerëzve nga brezi i gjyshërve e stërgjyshërve¹⁴; (0) “gjuhë e **zhdukur**” (*extinct*), kur atë nuk e flet ose nuk e kujton askush¹⁵.

Për të vlerësuar shkallën e transmetueshmërisë në breza të gjuhës romë sot, kishim përgatitur një pyetësor të posaçëm, të cilin, për shkak të kushteve të pandemisë së Covid-19, nuk arritëm ta plotësonim në terren. Shfrytëzuam atëherë të dhëna të paraqitura në studime autorësh, që janë marrë me probleme të natyrës sociale dhe ekonomike të komunitetit rom, dhe që vetëm në mënyrë të kufizuar kanë paraqitur fakte me karakter gjuhësor. Të dhënat e tyre, që pasqyrojnë shkallën e përdorimit të gjuhës romë në shtëpi, flasin edhe për shkallën e transmetueshmërisë së saj nga një brez në tjetrin në këtë komunitet: një gjuhë e folur në shtëpi është pas të gjitha gjasave një mjet komunikimi mes

¹⁴ Meqenëse fusha e studimit të *Rrezikimit gjuhësor* është e re, kuptohet që terminologjia e saj ende nuk është përpunuar sa duhet në gjuhën shqipe. Eda Derhemi, e vetmja studiuese shqiptare që punon në këtë fushë, duke dhënë kontribut të çmuar për studimin e gjuhës së arbëreshëve të Italisë, i ka dhënë në shqip termat, që shënojnë faktorët (3), (2), (1), përkatësisht si *gjuhë sigurisht e rrezikuar*, *gjuhë tej mase e rrezikuar*, *gjuhë skajshëm e rrezikuar* (Eda Derhemi, “Arbërishtja – gjuhë e rrezikuar”, në *Continuum, Revistë e Studimeve Arbëreshe*, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, viti I, nr. 1, 2020-2021, f. 212).

¹⁵ Brezinger et al, vep.cit, f. 7-8.

anëtarëve të familjes (fëmijë, prindër, gjyshër). Problemi qëndron te statistikat, të cilat ndryshojnë jo vetëm sipas autorëve, por edhe sipas studimeve të ndryshme të të njejtëve autorë.

Kështu, sipas studimit të De Soto *et al.* (2005)¹⁶, **65%** e popullsisë rome, që jeton në Shqipëri, përdor në shtëpi vetëm gjuhën rome, 29% përdor romishten e shqipen bashkë¹⁷ dhe vetëm 6% komunikojnë vetëm në shqip (këto janë kryesisht familje të krijuara nga martesat e përziera mes romësh e egjiptianësh ose romësh dhe joromësh).

Ndërkohë, sipas censusit të posaçëm të kryer vetëm për popullsinë rome (2014)¹⁸, rezulton një përqindje akoma më e madhe e saj, që e flet romishten në shtëpi: **80%** e familjeve rome shprehen se romishtja është gjuha kryesore, që ata flasin. Kurse dy burime të tjera raportojnë shifra shumë më të ulëta sa i takon përdorimit të romishtes në shtëpi si gjuhë amtare: **36%**¹⁹ dhe **55%**²⁰.

Të dhënat e mësipërme, që dëshmojnë se gjuha rome në Shqipëri flitet në shtëpi si gjuhë e parë nga pjesa më e madhe e fëmijëve ose e familjeve rome, tregojnë qartë për shkallën e lartë të ndërtransmetueshmërisë së romishtes në breza²¹, çka e klasifikon, me shumë gjasë, në nivelin (4) si **“gjuhë e pasigurt”**²².

¹⁶ Hermine De Soto, Sabine Beddies, Ilir Gëdeshi, *Roma and Egyptians in Albania, From Social Exclusion to Social Inclusion*, World Bank Working Paper, 2005, No.53, f.15-16.

¹⁷ Në një studim të mëvonshëm (Ilir Gëdeshi, Elira Jorgoni, *Mapping Roma Children in Albania*, Centre for Economic and Social Studies (CESS), Tirana, 2011, f.27) shifra e popullsisë rome, që përdor romishten e shqipen në shtëpi, dyfishohet, duke shkuar në **69.4%**.

¹⁸ *Census 2014, Banesat dhe popullata rome në Shqipëri*, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2014, f.22.

¹⁹ Patrick Simon, Emira Galanxhi, Olgeta Dhono, *Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: Profili social-demografik dhe ekonomik bazuar në Censusin 2011*, Tiranë, 2015, f.27 (përgatitur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri, në kuadër të Programit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” i financuar nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim).

²⁰ J. Kling, “Housing situation in numbers”, Roma in Central and Southeast Europe: Studim rajonal për romët i PNUD/BB/KE, 2011 (cituar sipas Patrick Simon et al., *Romët dhe egjiptianët në Shqipëri...*, vep.cit., f.27).

²¹ Brezinger et al, vep.cit, f. 7-8.

Në mbështetje të mendimit se romishtja në Shqipëri vijon të transmetohet ndër breza dhe se shumica dërrmuese e fëmijëve romë e flasin atë, madje e kanë gjuhën e vetme që njohin deri sa futen në shkollë, vjen edhe një përvojë e imja në terren si aktiviste e shoqërisë civile në kuadrin e projektit “Çdo fëmijë rom në kopsht” (UNICEF et al.).

²² Do të ishte me mjaft interes që, në një studim tjetër, të shiheshin lidhjet e ndërtransmetueshmërisë me variable shoqërore të tilla, si zona e banimit të romëve (zonë urbane, periferi zone urbane, zonë rurale), shkalla e arsimimit të tyre etj.

2. **Numri absolut i folësve** të një gjuhe është një tjetër faktor, që dëshmon shkallën e vitalitetit apo rrezikshmërisë, që paraqet ajo gjuhë, ndonëse, siç e vënë në dukje edhe Brezinger et al., “është e pamundur të bësh një interpretim objektiv të numrave absolutë”²³. Dihet, megjithatë, që bashkësitë gjuhësore me një numër të vogël folësish përgjithësisht janë më të ekspozuara ndaj ndikimeve, që rrezikojnë gjuhët e tyre, sesa bashkësitë e mëdha të folësve (edhe pse numri i madh i folësve nuk përbën gjithnjë garanci për mbijetesë dhe shëndet të një gjuhe). Por sa është numri i romishtfolësve në Shqipëri? Burime të ndryshme japin shifra të ndryshme, çka shpjegohet me vështirësitë në regjistrimin e kësaj popullsie për shkak të lëvizjeve të vazhdueshme brenda Shqipërisë, migrimeve të herëpashershme në shtete të tjera të një pjese të saj etj. Shifrat për romishtfolësit variojnë kështu nga **4025** persona, sipas të dhënave të censusit në Shqipëri të v. 2011²⁴, në **85 500** persona, sipas të dhënave të sjella nga studiuesit në kuadrin e përpjekjeve për vlerësim të popullsisë romishtfolëse në secilin prej shteteve europiane²⁵. Shifra me luhatje kaq të madhe jo që nuk e ndihmojnë studiuesin të nxjerrë përfundime të sakta, por e çorientojnë atë. Në censusin e ri, që do të ndërmerret në v.2022, duhet synuar për një vlerësim sasior më realist të popullsisë rome romishtfolëse.

3. **Numri i folësve të gjuhës së një grupi në raport me popullsinë e përgjithshme të grupit** është, gjithashtu, kriteri i rëndësishëm për të vlerësuar nivelin e rrezikimit të një gjuhe. Duhet pohuar që përlllogaritja e popullsisë rome, ashtu sikurse përlllogaritja e popullsisë romishtfolëse, përbën një sfidë jo të vogël për të njëjtat arsye, që i përmendëm në paragrafin e mësipërm. Kjo bën që shifrat për popullsinë rome në Shqipëri të variojnë e luhaten së tepërmi (80 000-150 000²⁶, 90 000²⁷, 18 276²⁸, 8301²⁹).

Nëse u referohemi shifrave zyrtare, sipas të cilave popullsia rome në Shqipëri është **8301** banorë, kurse romishtfolësit janë **4025**, rezulton që gjuhën rome e flet afro **50%** e romëve të Shqipërisë. Ky rezultat romishten e folur në Shqipëri nuk e klasifikon plotësisht në ndonjërin prej 6 niveleve të shkallës, që

²³ Brezinger et al, vep. cit., f.8.

²⁴ *Censuri i popullsisë dhe banesave 2011*, Instituti i Statistikave, Tiranë, 2012.

²⁵ Peter Bakker, Marcia Rooker, “The political status of the Romani Language in Europe”, Mercator-Working Papers num.2, 2001, f.9.

²⁶ Minority Rights Group International, *World Directory of Minorities and Indigenous Peoples – Albania: Roma*, 2008 (<https://www.refworld.org/docid/49749d6449.html>)

²⁷ Peter Bakker, Marcia Rooker, “The political status of the Romani Language in Europe”, art.cit., f.9.

²⁸ *Census 2014, Banesat dhe popullata rome në Shqipëri*, vep.cit., f.17.

²⁹ *Censuri i popullsisë dhe banesave 2011*, vep.cit.

i referohet faktorit 3, por e vendon diku aty në kufi mes nivelit 2 dhe 3, pra mes një gjuhe **vërtet të rrezikuar** (“gjuhën e flet shumica e popullsisë”) dhe një gjuhe **seriozisht të rrezikuar** (“gjuhën e flet një pakicë e popullsisë”). Jemi të prirur të besojmë se shifrat zyrtare nuk duhet të jenë fort të sakta dhe se numri i romishtfolësve në Shqipëri është më i madh. Për këtë flasin, ndonëse në mënyrë të tërthortë, edhe shifrat e sjella më sipër te faktori 1, që dëshmojnë përqindjen e lartë të familjeve rome, të cilat romishten e kanë gjuhën e tyre të shtëpisë.

Nëse u referohemi shifrave të publikuara prej studiuesve, shkalla e rrezikimit të gjuhës rome, ndryshe nga ç’ dëshmojnë shifrat zyrtare, rezulton të jetë e vogël. Kështu, sipas *Bakker et al.*, në një popullsi rome prej 90 000 personash, romishten e flet 95% e saj³⁰, një e dhënë kjo që e klasifikon romishten në nivelin (4), atë të një gjuhe **të pasigurt** (“gjuha flitet nga shumica dërrmuese e popullsisë”). Po në këtë nivel mund të përfshihej romishtja, nëse do t’i referoheshim pohimit të studiuesit Marcel Courthiade, një autoritet në fushën e studimeve mbi romët dhe romishten, sipas të cilit “shumica dërrmuese [e romëve të Shqipërisë – K.J.] e përdorin romishten në sferën private dhe atë publike”³¹, duke u nënkuptuar kështu që ajo **flitet** nga pjesa dërrmuese e saj.

4. Shkalla e vitalitetit apo rrezikimit të një gjuhe varet edhe nga domenet gjuhësore ku ajo përdoret. Sa më të shumta të jenë këto domene, aq më pak e rrezikuar konsiderohet gjuha, por, nëse domenet nisin të tkurren, të reduktohen a të humbasin, ajo është realisht e kërcënuar. Për të matur shkallën e rrezikimit të një gjuhe lidhur me këtë faktor, ekziston, po ashtu, një klasifikim prej 6 shkallësh, që shkon nga niveli (5) - ai më i ulëti i rrezikimit të një gjuhe, kur kjo përdoret në të gjitha domenet dhe me të gjitha funksionet - te niveli (0), kur një gjuhë nuk flitet më dhe konsiderohet e zhdukur³².

Çfarë mund të thuhet për romishten në Shqipëri lidhur me domenet, ku ajo përdoret sot? Statistikat janë të pakta, por, mbi të gjitha, kontradiktore. Në censusin e v.2014 për banesat dhe popullsinë rome në Shqipëri rezulton, siç u vu në dukje dhe më lart, që **80%** e kësaj popullsie romishten e përdor si mjet komunikimi në familje³³, kundrejt 65%³⁴ dhe 55%³⁵, që del në studime të tjera.

³⁰ Peter Bakker, Marcia Rooker, “The political status of the Romani Language in Europe”, art.cit., f.9

³¹ Marcel Courthiade, “Between Conviviality and Antagonism: The Ambiguous Position of the Romanies in Albania”, *Patrin*, no.3, 1995, f.11.

³² Brezinger et al, vep.cit, f. 9-10.

³³ *Census 2014, Banesat dhe popullata rome në Shqipëri*, vep.cit., f.22.

³⁴ De Soto et al., *Roma and Egyptians in Albania ...*, vep.cit., f.15.

³⁵ J. Kling, “Housing situation in numbers”, *Roma in Central and Southeast Europe...*, vep.cit., f.27.

Situata paraqitet krejtësisht ndryshe në një tjetër studim, sipas të cilit thuajse 70% e romëve në Shqipëri përdorin si gjuhë shtëpie romishten dhe shqipen³⁶.

Referuar domeneve të përdorimit të romishtes, cila është atëherë shkalla e rrezikimit të saj? Rreziku që i kanoset romishtes, paraqitet, pra, në nivele të ndryshme në varësi të të dhënave, që merren për bazë. Nëse do të merrnim për bazë tri statistikat e para, romishten mund ta klasifikonim në nivelin (4)³⁷, që do të thotë se ajo përdoret më së shumti në sferën private e, mbi të gjitha, në shtëpi, duke u nënkuptuar kështu përdorimimi i shqipes, gjuhës dominuese, në kontekste zyrtare dhe publike³⁸. Përdorimi i të dyja gjuhëve me funksione të ndryshme flet për një situatë diglosie dhe një shkallë të ulët rrezikimi të saj. Por, nëse do të merrnim për bazë statistikën e fundit (70%), romishten mund ta klasifikonim në një nivel, që flet për një shkallë më të lartë rrezikimi, në nivelin (3)³⁹, kur gjuha dominuese (shqipja) nis të depërtojë edhe në një domen siç është shtëpia, duke bërë kështu që gjuha jodominuese (romishtja) të humbasë terren. Në të dyja rastet, sidoqoftë, sa i takon domeneve ku përdoret, romishtja duhet konsideruar në një shkallë mesatare rrezikimi për sa kohë ajo vazhdon të funksionojë normalisht si gjuhë komunikimi brenda grupit etnik.

5. Shtrirja apo zgjerimi i përdorimit të një gjuhe në domene të reja flet, gjithashtu, për shkallën e vitalitetit të saj. Po a ia ka dalë dhe sa ia ka dalë romishtja në Shqipëri të përdoret në arsim, në media (gazeta, radio, televizion, internet) etj.?

Gjuha rome nuk ka askund një traditë përdorimi në sferat publike, çka përbën edhe një prej sfidave më të mëdha të saj. Historikisht romishtja te ne, por jo vetëm, nuk ka shërbyer kurrë si gjuhë **arsimimi** në asnjë nivel shkollimi. Këtë funksion ajo nuk e kryen as sot, kur ekziston tashmë kuadri ligjor, që garanton arsimimin të pakicave kombëtare në gjuhët e tyre amtare⁴⁰. Dhe mungesa e arsimimit të një bashkësie gjuhësore në gjuhën e saj amtare dihet që e kërcënon seriozisht një gjuhë me rrezikun e zhdukjes⁴¹.

Një nga faktorët më të rëndësishëm, që pengon realizimin e arsimimit të fëmijëve të pakicave rome në gjuhën e tyre amtare, është mungesa thuajse e

³⁶ Ilir Gëdeshi, Elira Jorgoni, *Mapping Roma Children in Albania...*, vep.cit., f.27.

³⁷ Brezinger et al, vep.cit, f. 9.

³⁸ “Gjuha rome është e margjinalizuar në media, e margjinalizuar në arsim, irrelevante në jetën publike dhe e neglizhuar në administratë” (Dieter W. Halwachs, *Roma Language, Sociolinguistics*, Council of Europe, Project Education of Roma Children in Europe, f.2)

³⁹ Brezinger et al, vep.cit, f. 10.

⁴⁰ Shih për këtë më poshtë, te faktori 7, ku trajtohet çështja e politikave gjuhësore të ndjekura prej shtetit shqiptar ndaj pakicave kombëtare.

⁴¹ Shih më poshtë pikën 6.

plotë e mësuesve romë. Nëse mësues të gjuhëve të tjera të pakicave kombëtare përgatiten prej kohësh nëpër institucione arsimore në Shqipëri⁴², këto të fundit nuk kanë përgatitur ndonjëherë mësues të gjuhës rome. Hapja e një dege studimi për gjuhë shqipe dhe rome në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan (në vitet shkollore 2016-2017, 2017-2018) nuk dha ndonjë rezultat të frytshëm⁴³.

Përdorimin e romishtes romët *thujse* nuk ia kanë dalë ta shtrijnë as në **median e shkruar**. Aktualisht nuk ka asnjë organ shtypi që del në këtë gjuhë. Sa i takon **medias audiovizive**, operatori i vetëm që transmeton lajme në gjuhët e pakicave, ndër të cilat edhe në gjuhën rome, është RTSH2, një kanal i posaçëm i të vetmit transmetues publik në vend, RTSH. Bëhet fjalë për një edicion informativ me një kohëzgjatje prej 5 minutash, që transmetohet rregullisht prej dhjetorit të v. 2016 nga e hëna deri të premten. Deri sot nuk ka asnjë operator privat, që transmeton në ndonjë prej gjuhëve të pakicave, përfshirë edhe në romishte.

Si duhet vlerësuar atëherë shkalla e rrezikimit të gjuhës rome në Shqipëri sa i takon përdorimit të saj në domene të reja? I vetmi domen i ri, siç e pamë, është ai i medias audiovizive, por përdorimi i romishtes aty është tejet i kufizuar si nga pikëpamja sasiore (25 minuta transmetim në javë), ashtu dhe ajo cilësore (transmetohen vetëm edicione lajmesh). Kjo e rrit jashtëzakonisht shkallën e rrezikut, që i kërcënohet romishtes, duke e vendosur këtë gjuhë në nivelin e parafundit, nivelin (1) (“gjuha përdoret në vetëm pak domene të reja”), në klasifikimin prej 6 shkallësh a nivelesh rreziku⁴⁴.

6. Ekzistenca ose jo e materialeve të shkruara, që shërbejnë për arsimimin gjuhësor dhe alfabetizimin e bashkësisë, e cila e flet një gjuhë, ndikon drejtpërdrejt në shkallën e vitalitetit apo rrezikimit të asaj gjuhe. Po si paraqitet gjendja e romishtes në Shqipëri lidhur me këtë faktor? Situata është e tillë që ekzistojnë shumë pak materiale të kësaj natyre në romishte: një abetare rome⁴⁵ së bashku me librin e mësuesit⁴⁶, një gramatikë e gjuhës rome⁴⁷ si dhe

⁴² Mësuesit e gjuhës greke në Shqipëri përgatiten në shkollën e mesme pedagogjike të Gjirokastrës dhe në Universitetin “Eqrem Cabej” në Gjirokastrë (Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek). Greqishtja studiohet, gjithashtu, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës (Departamenti i Gjuhës Greke). Po në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (Departamenti i Gjuhës Sllavo-Balkanike) studiohet edhe gjuha maqedonase.

⁴³ Sipas një komunikimi gojor të pedagogut të kursit universitar të gjuhës rome, Emiliano Aliu, në këtë degë arritën të diplomoheshin vetëm dy studentë nga komuniteti rom.

⁴⁴ Brezinger et al, vep.cit, f. 11.

⁴⁵ *Romano Startorro*, Sarajevo: Svjetlost, 1990, 64 fq.

një fjalor dygjuhësh romisht-shqip dhe shqip-romisht⁴⁸, vepra të romologut të shquar dhe një prej themeluesve të romologjisë, Marcel Courthiade. Për më tepër, këto materiale nuk njihen e nuk janë të aksesueshme nga komuniteti i romëve të Shqipërisë, pasi, siç e thamë, mësimi i romishtes dhe në romisht nuk është pjesë e kurrikulës shkollore. E, meqenëse arsimimi në një gjuhë të caktuar është thelbësor për vitalitetin e asaj gjuhe, romishtja, në këtë aspekt, duhet konsideruar si një gjuhë shumë e rrezikuar. Referuar modelit të vlerësimit të UNESCO-s për këtë faktor, të përbërë po prej 6 nivelesh, që i korrespondojnë shkallëve të ndryshme të rrezikimit të një gjuhe, romishten në Shqipëri do duhet ta përfshinim, pas shumë gjasash, në nivelin (2)⁴⁹.

Në këtë situatë të romishtes në Shqipëri ka patur e ka pa dyshim ndikimin e vet edhe situata e romishtes në përgjithësi si një gjuhë me traditë krejtësisht gojore dhe me një histori shkrimi shumë të re, as njëshekullore, të përbërë nga një mori përpjekjesh për grafizim⁵⁰. Pas përdorimit të një vargu alfabetesh për shkrimin e saj (latin, cirilik, grek, devanagari), ende sot nuk ka një alfabet të vetëm të përbashkët për shkrimin e romishtes. Nuk ekziston, gjithashtu, një drejtshkrim a ortografi standarde, ndërkohë që nuk kanë munguar përpjekjet për krijimin e varieteteve të kodifikuara qoftë për dialekte të veçanta, qoftë për një varietet të vetëm mbidialektor. Prirja mbizotëruese, gjithsesi, mbetet ajo e një modeli policentrik, ku bashkekzistojnë modele të ndryshme kodifikimi⁵¹.

Po çfarë alfabeti e drejtshkrimi kanë zgjedhur të përdorin ata të paktë individë romë në Shqipëri, në rastet kur u është dashur ta shkruajnë gjuhën rome? Edicionet informative, që përgatiten dhe lexohen çdo ditë në gjuhën rome, prej të paktën katër vjetësh, në kanalin RTSH2, shkruhen, sipas dëshmive gojore të autorit të tyre,⁵² me alfabetin e përpunuar prej romologut Marcel Courthiade, të miratuar në Kongresin IV Botëror të Romëve në Poloni (1990), i cili konsiderohet si alfabeti zyrtar i organizatës Bashkimi

⁴⁶ *Romano Startoro*, Sarajevo: Svjetlost, 1990, 92 fq. Libri është shkruar në shqip, serbokroatisht, sllovenisht, turqisht, bullgarisht, maqedonisht, rumanisht dhe greqisht, me qëllim që të përdoret nga mësuesit romë kudo në Ballkan.

⁴⁷ *Gramatika e gjuhës rrome*, vëll.I: njohuri të përgjithshme, fonologji, morfologji, Tiranë, 1989, 179fq.

⁴⁸ *Fjalor rromisht-shqip: i të folmeve rrome në përdorim në Shqipëri: meçkarisht, kabuxhisht, rupanisht e shkodranisht, rreth 4400 fjalë; me një fjalorth shqip- rromisht, rreth 3000 fjalë*, Rromani Baxt, Tirana, 2004, 252 fq.

⁴⁹ Brezinger et al, vep.cit, f. 12.

⁵⁰ Yaron Matras, "Writing Romani: The pragmatics of codification in a stateless language", *Applied Linguistics* 20(4), 1999, f. 481-502.

⁵¹ Yaron Matras, "The Future of Romani: Toward a Policy of Linguistic Pluralism", European Roma Rights Centre, 11 March 2005.

⁵² Olsi Sherifi, gazetar me origjinë rome, i cili ka mësuar në mënyrë autodidakte të shkruajë e të lexojë në gjuhën rome.

Ndërkombëtar i Romëve (International Roman Union) (1971)⁵³. Ky është në të vërtetë alfabeti i vetëm i përdorur në ato pak tekste të shkruara e të prodhuara në Shqipëri nga 1990-a e këtej, si fletëpalosje, postera etj.⁵⁴. Për këtë i duhet njohur merita Marcel Courthiade-s, i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për komunitetin rom të Shqipërisë jo vetëm përmes veprave për dokumentimin dhe kodifikimin e romishtes, por edhe zbatimit të një vargu projektesh të rëndësishme të natyrës sociale e kulturore. Prania e tij fizike e gjatë dhe e pandërprerë në Shqipëri ka patur, gjithashtu, rolin e vet të pazëvendësueshëm.

7. Qëndrimet dhe politikat gjuhësore qeveritare dhe institucionale, përfshirë statusin zyrtar dhe përdorimin, janë një tjetër tregues për shkallën e rrezikimit të një gjuhe. Ç'mund të thuhet për romishten në këtë aspekt? Gjuha rome në Shqipëri ka prej të paktën 4 vitesh statusin e një gjuhe pakice kombëtare, ndaj së cilës shteti ka shpallur një politikë mbrojtjeje, mbështetjeje e nxitjeje për zhvillim. Kjo politikë gjen shprehjen e saj të hapur në një varg dokumentesh ligjore, si: *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* (1998)⁵⁵; *Konventa Kuadër Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*⁵⁶, një ligj i prodhuar prej Këshillit të Europës (1994) e i ratifikuar prej shtetit shqiptar (1999)⁵⁷; *Ligji Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë* (2017)⁵⁸; *Ligji Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë* (2012)⁵⁹; *Ligji Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë* (1998)⁶⁰; si dhe disa ligje të tjera e një numër vendimesh qeveritare. Në këto dokumente garantohen një sërë të drejtash gjuhësore për pakicat kombëtare, ndër të cilat e drejta për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre kulturor e gjuhësor; e drejta për t'u arsimuar në gjuhën amtare; për ta përdorur këtë të fundit jo vetëm në jetën private, por edhe atë publike; e drejta për t'u informuar në gjuhën amtare; për të patur median e shkruar dhe elektronike në atë gjuhë etj.

⁵³ Ky është një prej disa alfabeleve që përdoren më së shumti për shkrimin e gjuhës rome, si alfabeti “panvllah”, ai “i anglicizuar” etj.

⁵⁴ Alfabeti i propozuar nga Courthiade përdoret në sistemin arsimor rumun, por në mënyrë sporadike edhe në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

⁵⁵ Neni 18, Neni 20, Neni 22, Neni 23, Neni 24.

⁵⁶ Neni 5, Neni 6, Nenet 9-14.

⁵⁷ Përmes ligjit nr. 8496, dt. 3.06.1999.

⁵⁸ Nenet 12-15.

⁵⁹ Nr. 69/2012, ndryshuar me ligjin nr. 56/2015, dt. 28.5.2015. Shih Nenin 10, “Arsimimi për pakicat kombëtare”.

⁶⁰ Nr. 8410, dt. 30.9.1998 (ndryshuar me ligjin nr. 8655 date 31.07.2000; ligjin nr. 8794 date 10.05.2001; ligjin nr.9016 date 20.2.2003; ligjin nr.9124 date 29.07.2003; ligjin nr. 9531 dt. 11.05.2006; ligjin nr. 9677, dt. 13.01.2007). Shih nenet 36, 37, 68.

Edhe pse zyrtarisht shtet njëgjuhësh⁶¹, Shqipëria rezulton me një kuadër ligjor, që u siguron gjuhëve të pakicave mbrojtje e përkrahje të plotë. Një kuadër ligjor i tillë flet kështu për një politikë gjuhësore pluraliste të shtetit shqiptar, çka do ta rendiste këtë politikë në shkallën më të lartë të klasifikimit (5), kur shteti dhe institucionet u japin të gjitha gjuhëve mbështetje a përkrahje të barabartë. Gjykuar mbi bazën e një politike të tillë, gjuhës rome në Shqipëri nuk i kanoset kurrfarë rreziku. Por të mos harrojmë që shpallja e një politike gjuhësore nuk nënkupton automatikisht edhe zbatimin e saj, çka bën shpesh që mes politikave të shpallura dhe praktikave të ekzistojë një hendek i thellë. Kjo është situata, që ka të bëjë me disa gjuhë pakicash kombëtare në Shqipëri të shpallura rishtas si të tilla, të njohura me termin “gjuhë joterritoriale”⁶² (gjuha rome dhe arumanishtja). Ligji *Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë* (2017), ndonëse në fuqi prej disa vitesh, është pasuar me daljen e një numri shumë të kufizuar aktesh nënligjore⁶³, të cilat e kanë penguar praktikisht zbatimin e tij për të mundësuar realizimin e politikës gjuhësore të shpallur.

8. Qëndrimet e anëtarëve të komunitetit ndaj gjuhës së vet kanë, gjithashtu, pjesën e tyre të rëndësishme në vlerësimin e shkallës së rrezikimit të gjuhës. Këto mund të jenë qëndrime pozitive, negative ose asnjënjëse, ndër të cilat qëndrimet pozitive shërbejnë si një nxitje për një përdorim më të madh

⁶¹ “Gjuha zyrtare e Republikës së Shqipërisë është shqipja” (*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* (1998), Neni 14.1.)

⁶² Termi “gjuhë joterritoriale”, qe del dhe përkufizohet për herë të parë te *Karta Evropiane për Gjuhët e Pakicave ose Krahinore*, nenkupton ato “gjuhë të përdorura nga qytetarët e një shteti, të cilat ndryshojnë nga gjuhët e përdorura prej pjesës tjetër të popullsisë së atij shteti, por që, edhe pse të përdorura tradicionalisht brenda territorit të shtetit, nuk mund të identifikohen me një trevë të caktuar të tij” (Neni 1/c).

⁶³ VKM nr.561, dt. 29.9.2018, *Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare*. VKM nr. 562, dt. 29.9.2018, *Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë*. VKM nr. 227, dt. 17.4.2019, *Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare*. VKM nr. 463, dt. 3.7.2019, *Mbi përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat, që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre*. VKM nr. 1155, dt. 24.12.2020, *Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare*.

dhe zhvillim të mëtejshëm të gjuhës, duke rritur kështu vitalitetin e saj. Të tjerat, kuptohet, ndikojnë në rritjen e shkallës së rrezikimit të gjuhës si pasojë e reduktimit të përdorimit dhe mungesës së përpjekjeve për ruajtjen dhe zhvillimin e saj, çka çon më pas në braktisjen e saj dhe përfaqimin e një gjuhe tjetër.

Vlerësimi sasior apo matjet e këtij faktori për anëtarët e komunitetit rom në Shqipëri, përmes një pyetsori që kishim përgatitur, nuk qe e mundur të realizoheshin për arsyeën që e bëmë të ditur më lart. Kemi në dorë, ndërkaq, një të dhënë të rëndësishme, sipas së cilës 99% e romëve e konsiderojnë romishten si elementin kryesor, që i dallon ata prej shqiptarëve⁶⁴. Kjo dëshmon se romët e Shqipërisë kanë një shkallë tepër të lartë të vetëdijes mbi përkatësinë apo identitetin e tyre etnik, pavarësisht numrit real të folësve të romishtes. Një gjuhë i ka “të numëruara ditët”, kur folësit e saj nisin ta humbasin kujtesën identitare etnike e kulturore, por ajo i ka të mëdha gjasat për t’u fuqizuar e zhvilluar, nëse kjo kujtesë ruhet e përpunohet më tej.

9. Sasia dhe cilësia e dokumentimit të një gjuhe është një tregues tjetër me vlerë, që dëshmon shkallën e rrezikimit të saj. Dokumentimi nënkupton ekzistencën jo vetëm të materialeve të shkruara, si fjalorë, gramatika, tekste të ndryshme, letërsi, gazeta etj., por edhe të materialeve të regjistruara audio e video të zbardhura/transkriptuara, të përkthyer dhe të anotuara⁶⁵. Sa më shumë dhe sa më mirë të jetë e dokumentuar një gjuhë, aq më pak i kanoset asaj rreziku i zhdukjes. Përkundrazi, mungesa e dokumentimit ose dokumentimi i paktë e jociësor e vënë atë në një situatë jo të favorshme⁶⁶.

Si rezulton niveli i dokumentimit të romishtes? Kemi të bëjmë me një gjuhë transnacionale, pra, me një gjuhë, që ka një traditë si mjet komunikimi në një territor mjaft të gjerë, që nuk njih kufij shtetërorë. Në kushte të tilla është krejt e kuptueshme që romishtja funksionon përmes varietetesh të shumta dialektore, gjithsecili i ndikuar prej gjuhës/gjuhëve dominuese me të cilat ka qenë e është në kontakt. Edhe pse gjuhë deri vonë e pashkruar e, për pasojë, e lëvruar shumë pak në letërsi e media të shkruar, romishtja rezulton një gjuhë e dokumentuar, e përshkruar dhe e studiuar mirë nga pikëpamja gjuhësore.

⁶⁴ Të tjerë konsiderojnë si elemente kulturore themelore muzikën (80%), festat (80%), ceremonitë familjare (74%), zanatin e punimit me kashtë (67%), veshjet e grave (63%). Shih De Soto *et al.*, *Roma and Egyptians in Albania ...*, vep.cit., f.15.

⁶⁵ Brezinger *et al.*, vep.cit., f. 16.

⁶⁶ Për ndonjë studiues “sasia dhe cilësia e dokumentimit nuk përbën në vetvete një indeks për vlerësimin e vitalitetit. Ekzistojnë gjuhë në botë, të cilave u mungon dokumentimi e, megjithatë, kanë folës. Sikurse ka të tjera, që janë të dokumentuara mirë, por që po i humbasin folësit krejt” (Ogone John Obiero, “From Assessing Language Endangerment ...”, art.cit., f.208).

Mjafton të përmendim vetëm dy ndërmarrje shkencore shumë të rëndësishme, që kanë realizuar dokumentimin dhe përshkrimin e dialekteve rome: *Romlex*, një bazë të dhënash leksikore online, që dokumenton leksikun e romishtes në 25 varietete të saj me përkthim në 15 gjuhë të botës; dhe një bazë të dhënash të morfosintaksës rome për më shumë se 100 varietete të romishtes ngritur pranë Universitetit të *Manchester*-it në kuadrin e një projekti ndërkombëtar.

Sa u takon të folmeve rome në Shqipëri - pjesë përbërëse e dialektit të njohur si *romishte ballkanike* -, mjaft të ndikuara prej shqipes, gjuhës dominuese, me të cilën ato kanë qenë në kontakt, nuk di të ketë patur përpjekje në vend për dokumentimin e tyre përmes regjistrimesh audio e video⁶⁷ dhe se sa përfaqësohen ato në dy ndërmarrjet e sipërpërmendura. Romishtja, sidoqoftë, duhet konsideruar si një gjuhë e dokumentuar shumë mirë, çka i jep asaj pikavarazhin më të lartë (5) në klasifikimin e faktorit përkatës.

Vlerësimet e mësipërme sasiore (matjet sipas sistemit 6-pikësh), por edhe ato cilësore (konsiderimi i disa faktorëve si më të rëndësishëm se të tjerët sa i takon peshës që ato kanë për indeksin e vitalitetit), na sugjerojnë që shkalla e rrezikimit të romishtes në Shqipëri është më e ulët nga ç'konstatohet në *UNESCO Atlas of the World's Languages in Danger*. Ajo, pas gjasash, duhet klasifikuar si një "gjuhë e pasigurt"/*unsafe language* (4) dhe jo një "gjuhë vërtetë e rrezikuar"/*definitely endangered* (3). Megjithatë, përtej etiketimeve, të cilat gjithmonë ngjallin diskutime, vlerësimet e bëra duhet të shërbejnë si orientim bazë për të ndërmarrë veprime e ndërhyrje me karakter mbështetës, fuqizues a rivitalizues ndaj romishtes si gjuhë e rrezikuar.

Shkalla e rrezikimit të romishtes te ne, sikurse e pamë më lart, rezulton e lartë veçanërisht për faktin se ajo nuk është shtrirë apo nuk e ka zgjeruar përdorimin e saj në domene të reja⁶⁸, por edhe pse nuk ekzistojnë materiale të shkruara, që shërbejnë për arsimimin gjuhësor dhe alfabetizimin e romëve⁶⁹. Pra, romishtja nuk ka treguar kurrfarë prirjeje për zgjerimin e sferave të përdorimit duke vijuar të mbetet një gjuhë thuajse tërësisht e folur në domenin e shtëpisë dhe me përdorim vetëm në sferën private. Po kështu, romishtja nuk funksionon ende si gjuhë e shkollës dhe e arsimit, me gjithë kuadrin ligjor, që mundëson përdorimin e saj. Çfarë mund të bëhet? Hapi i parë që duhet ndërmarrë, është ideimi apo konceptimi i kurrikulës zyrtare përkatëse, ku të mbahet mirë parasysh fakti se pjesa dërrmuese e fëmijëve romë të moshës parashkollore janë folës njëgjuhësh në gjuhën e tyre amtare. Në këto rrethana

⁶⁷ As regjistrimet e lajmeve në gjuhën rome, që jepen çdo ditë në RTSH2, nuk ruhen në arkivin përkatës (sipas pohimit të një burimi nga redaksia e lajmeve në gjuhët e pakicave kombëtare).

⁶⁸ Faktori 5, i vlerësuar me 1 pikë.

⁶⁹ Faktori 6, i vlerësuar me 2 pikë.

studiuesit e fushës sugjerojnë një kurrikul, që parashikon alfabetizimin e fëmijëve në gjuhën e tyre amtare, në romishte, për të kaluar më pas në mësimin e gjuhës së shumicës, e për të vijuar më tej në arsimim dygjuhësh për krijimin e një bilinguizmi të qëndrueshëm⁷⁰.

Me realizimin e arsimit në gjuhën rome janë të lidhura ngushtë edhe dy çështje shumë të rëndësishme, pa të cilat ajo nuk mund të realizohet: e para, përgatitja e mësuesve të specializuar në mësimdhënien e romishtes si lëndë më vete, por dhe në mësimdhënien e lëndëve të tjera në gjuhën rome; e dyta, sigurimi i materialeve shkollore të shkruara.

Sa u takon **mësuesve**, këta duhet të jenë medoemos nga radhët e komunitetit rom, me një formim solid në fushën e mësimdhënies në përgjithësi e në mënyrë të veçantë në mësimdhënien e romishtes. Në Shqipëri nuk ka patur dhe nuk ka një institucion për përgatitjen e kuadrit mësimdhënës të gjuhës rome e në gjuhën rome. Për t'i siguruar ata shteti shqiptar mund të dërgonte fillimisht të rinj romë për të studiuar në institucione arsimore të vendeve me përvojë në këtë drejtim, si në Rumani, Çeki, Sllovaki, Hungari etj., e më pas të planifikonte ngritjen e tyre në vend.

Lidhur me **materialet shkollore të shkruara**, si tekste shkollore, literaturë mbështetëse, libra, fjalorë etj., problemi që del, është varieteti në të cilin duhet të jenë ato. Ende nuk ka, siç e thamë edhe më lart, një varietet standard të romishtes, pasi kemi të bëjmë me një gjuhë të një diaspore, që është e shpërndarë thuajse në tërë botën e, për pasojë, nuk ka një autoritet të vetëm të angazhuar në veprimtari planifikuese gjuhësore për ta ndryshuar statusin e saj nga një gjuhë vernakulare në një gjuhë standarde. Ekzistojnë ndërkaq disa varietete të kodifikuara të romishtes në shtete të ndryshme (Sllovaki, Austri, Hungari, Serbi, Rumani etj.), të ngritura mbi dialekte lokale, që fliten nga popullsia rome atje, varietete të cilat përdoren si gjuhë arsimimi, gjuhë e medias etj. Ekzistenca e një modeli të tillë kodifikimi policentrik na vë kështu përpara zgjedhjes: ose të krijojmë një varietet të kodifikuar të romishtes që flitet në Shqipëri (por që kërkon burime financiare e njerëzore të mëdha), ose të huazojmë për nevojat tona një varietet të gatshëm prej atyre që përmendëm më lart. Pa u zgjidhur çështja e varietetit që do të përdoret, nuk mund të flitet praktikisht për arsimim të romëve në gjuhën e tyre amtare.

Ndërhyrjet e mësipërme, të ashtuquajtura “nga lart-poshtë”, të cilat ndërmerren e realizohen nga institucionet shtetërore në vende, ku gjuhët e pakicave kombëtare njihen e respektohen ligjërisht, nuk mund të jenë të suksesshme e frytdhënëse, nëse nuk mbështeten e nuk nxiten prej komunitetit, që e flet gjuhën e pakicës, që rrezikon të bjerret. Po për ta realizuar këtë komuniteti duhet të jetë i ndërgjegjësuar për rrezikun, që i kanoset gjuhës së vet. A e kanë vallë këtë shkallë ndërgjegjësimi romët në Shqipëri? Vështirë të

⁷⁰ Yaron Matras, “The Future of Romani...”, art.cit.

jepet një përgjigje pozitive për sa kohë nuk ka ende një elitë të dalë prej këtij komuniteti, së cilës, si kudo tjetër, do t'i takonte detyra jo vetëm për këtë, por edhe për ta nxitur komunitetin për të ushtruar presion për kërkesat e veta. Nuk ka, pra, kurrfarë aktivizmi social nga radhët e romëve, aq më pak aktivizëm për të realizuar të drejtat e tyre gjuhësore. Problemet e mëdha ekonomike dhe shoqërore, që vazhdon të ketë ky komunitet, i kanë lënë në hije çështjet e natyrës kulturore e gjuhësore të tij.

Ruajtja, fuqizimi dhe rivitalizimi i një gjuhe të rrezikuar është një proces i gjatë e kompleks, që kërkon njëherësh angazhimin e shtetit dhe të komunitetit, që e flet gjuhën e rrezikuar. "...suksesi i këtij procesi është i vështirë dhe kërkon një ndërhyrje rigoroze teorike dhe empirike, mbështetje financiare e legale dhe sidomos një mobilizim total të komunitetit dhe institucioneve të tij nëpërmjet ideologjish të fuqishme"⁷¹

BIBLIOGRAFI

- Bakker, Peter & Kyuchukov, Hristo (eds.) (2000), *What is the Romani Language*, Hartfield, University of Hertfordshire Press.
- Bakker, Peter, Rooker, Marcia, (2001), "The political status of the Romani Language in Europe", Mercator-Working Papers num.2, 2001, f. 1-37.
- Brenzinger, Matthias et al., (2003), *Language Vitality and Endangerment*, Document submitted to the *International Expert Meeting on UNESCO Programme Safeguarding of Endangered Languages*, Paris, 10-12 March, 25 fq.
- Census 2014, Banesat dhe popullata rome në Shqipëri*, (2014), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë.
- Censusi i popullsisë dhe banesave 2011* (2012), Instituti i Statistikave, Tiranë (www.instat.gov.al).
- Courthiade, Marcel, (1989), *Gramatika e gjuhës rome*, vëll.I: njohuri të përgjithshme, fonologji, morfologji, Tiranë, 179 fq.
- Courthiade, Marcel, (1990), *Rromano Startorro*, Sarajevo: Svjetlost, 64 fq.
- Courthiade, Marcel, (1990), *Rromano Startorro*, Sarajevo: Svjetlost, 92 fq.
- Courthiade, Marcel, (2004), *Fjalor rromisht-shqip: i të folmeve rome në përdorim në Shqipëri: meçarisht, kabuxhisht, rupanisht e shkodranisht, rreth 4400 fjalë; me një fjalorth shqip- rromisht, rreth 3000 fjalë*, Rromani Baxt, Tirana, 252 fq.
- De Soto, Hermine, Beddies, Sabine, Gëdeshi, Ilir (2005), *Roma and Egyptians in Albania, From Social Exclusion to Social Inclusion*, World Bank Working Paper, No.53.

⁷¹ Eda Derhemi, "Arbërishtja – gjuhë e rrezikuar", art.cit., f. 217.

- Derhemi, Eda (2020-2021), “Arbërishtja – gjuhë e rrezikuar”, në *Continuum, Revistë e Studimeve Arbëreshe*, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, viti I, nr. 1, 2020-2021, f. 211-224.
- Gëdeshi, Ilir, Jorgoni, Elira, (2011), *Mapping Roma Children in Albania*, Centre for Economic and Social Studies (CESS), Tirana.
- Gomashie, Grace A., Terborg, Roland, “Nahuatl, selected vitality indicators and scales of vitality in an Indigenous language community in Mexico”, në *Open Linguistics* <https://doi.org/10.1515/opli-2021-0010>
- Grenoble, Lenore, and Whaley, Lindsay (eds.), (1998), *Endangered Languages: Current Issues and Future Prospects*, Cambridge: Cambridge University Press, 361 fq.
- Halwachs, Dieter W., *Roma Language*, Sociolinguistics, Council of Europe, Project Education of Roma Children in Europe, f.2)
- Koinova, M., (2000), *Minorities in Southeast Europe: Roma of Albania*, Center for Documentation and Information on Minorities in Europe – Southeast Europe (CEDIME).
- Matras, Yaron, (1999), “Writing Romani: The pragmatics of codification in a stateless language”, *Applied Linguistics* 20(4), f. 481-502.
- Matras, Yaron (2005), “The Future of Romani: Toward a Policy of Linguistic Pluralism”, European Roma Rights Centre, 11 March.
- Minority Rights Group International, *World Directory of Minorities and Indigenous Peoples – Albania: Roma*, 2008 (<https://www.refworld.org/docid/49749d6449.html>)
- Obiero, Ogone John, (2010), “From Assessing Language Endangerment or Vitality to Creating and Evaluating Language Revitalization Programmes”, *Nordic Journal of African Studies* 19(4): 201–226.
- Pakica ballkano-egjiptiane dhe komunitetet etnokulturore në Shqipëri (2019)*, Akte të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare me të të njëjtin titull, botuar nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” dhe Lëvizja Riore Egjiptiane dhe Rome, Elbasan.
- Racova, Anna, Samko, Milan (2017), “On the vitality and endangerment of the Romani Language in Slovakia”, *Asian and African Studies* 26(2), f. 185-208.
- RAPORTI i pestë periodik paraqitur nga Republika e Shqipërisë mbështetur në nenin 25, paragrafi 2, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e minoriteteve” (2021)*, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Simon, Patrick, Galanxhi, Emira, Dhono, Olgeta (2015), *Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: Profili social-demografik dhe ekonomik bazuar në Censusin 2011*, Tiranë (përgatitur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri, në kuadër të Programit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” i financuar

nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim).
Sorescu-Marincovic, Annemarie, Miric, Mirjana, Cirkovic, Svetlana (2020),
“Assessing Linguistic Vulnerability and Endangerment in Serbia. A
Critical Survey of Methodologies and Outcomes”, në *Balkanica LI*
(2020), f. 65-104.

SUMMARY

A PRELIMINARY ASSESSMENT OF THE ENDANGERMENT LEVEL OR VITALITY OF THE ROMANI LANGUAGE IN ALBANIA

The paper aims at providing a preliminary assessment of the sociolinguistic situation of the Romani language in Albania considering the endangerment degree or vitality, based on the criteria proposed in the 2003 UNESCO document. Taking in consideration the findings and legal framework for the minority languages in Albania, the paper provides also some proposals on language revitalization.